

# RAPORT

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në “Menaxhim Biznesi”

Universiteti Privat Albania University

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr. Halit Xhafa

Prof.Asoc.Dr Etleva Leskaj




Tetor, 2018

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc në "Menaxhim Biznesi"**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
	Departamenti përgjegjës	Departamenti i Shkencave Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 26.05.2010
4	VKA e Akreditimit të parë/Urdhëri/ /VBA i akreditimi i parë	VKA Nr. 152, datë 31.03.2016/ Urdhër i MAS Nr. 240, datë 09.05.2016 (akreditim me kusht)/ VBA Nr. 33, datë 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Menaxhim Biznesi"
6	Cikli i studimit:	Cikli I
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët:	N/A
14	Diplomë e dyfishtë:	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2010-2011
17	Numri i studentëve	57 (37 studemtë për herë të parë dhe 20 studentë të transferuar)

**Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi

Programi i studimit Bachelor në 'Menaxhim Biznesi' implementohet nga departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Programi Bachelor në 'Menaxhim Biznesi' është licencuar me VKM nr. 408, datë 26.05.2010, është akredituar për herë të parë me kusht me VKA nr.152, datë 31.03.2016, akredituar me kusht me Urdhër të Ministrit nr. 240, datë 09.05.2016. Pas plotësimit të kushteve mori akreditimin e parë nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 33, datë 19.05.2017.

Departamenti i Shkencave Ekonomike është njësi bazë akademike që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fusha të lidhura me profilet ekonomike të njohura dhe licencuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Departamenti ofron dy programe studimi të ciklit të parë (Bachelor në 'Financë-Bankë' dhe Bachelor në 'Menaxhim Biznesi'), katër programe studimi të ciklit të dytë (Master Profesional në 'Administrim Biznesi', Master Profesional në 'Menaxhim Bankar dhe Financiar', Master i Shkencave në 'Administrim Biznesi' dhe Master i Shkencave në 'Menaxhim Bankar') si dhe një program studimi të ciklit të tretë (Doktoratë në 'Financë'- jo aktive).

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Prof.Dr. Halit Xhafa
- Prof.Asoc.Dr Etleva Leskaj

Koordinatorë teknikë të kësaj procedure kanë qenë R. Qatipi dhe E. Xhako (specialistë në ASCAL).

Më datë 18.10.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 7/23 Prot., datë 18.10.2018 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", AU është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 22.10.2018, AU përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 299/1 Prot., datë 22.10.2018, "Kthim përgjigje shkresës Nr. 7/23 Prot., datë 18.10.2018".

Në këtë dokument institucioni shpreh dakortësinë me Draft-RVJ. Draft Raporti bëhet Raport përfundimtar i vlerësimit.

### ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

#### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit

Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr.33, datë 19.05.2017, nuk ka paraqitur në mënyrë eksplicite rekomandime përse i përket këtij programi studimi, por ndërmjet të tjerash ka konstatuar se rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të kushteve përkundrejt Standardeve Shtetërore "Për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë të IAL" dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është "i përmbush pjesërisht standardet".

Ndër konstatimet që mbështesin këtë vlerësim përmenden:

- a. Numri i stafit akademik efektiv me grada e tituj dhe Raporti Personel Akademik Efektiv/ personel Akademik me kontratë është përmirësuar, por ende nuk është në përputhje të plotë me standardet e kërkuara;
- b. Stafi akademik efektiv është i përfshirë në më shumë se dy detyra dhe ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv nuk përcaktohet në mënyrë të detajuar;
- c. Nuk ka evidence në dokumentimin e aktiviteteve si leksione të hapura, seminare, workshop, etj.;

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

### a. AU e ka plotësuar kete rekomandim

Nga te dhënat e siguruar nga institucioni, ne lidhje me stafin akademik te perfshire ne mësimdhënie ne programin e studimit Bsc. në “Menaxhim Biznesi”, rezulton se për vitin akademik 2017-2018, në këtë program janë përfshirë 33 pedagogë. Keto te dhëna paraqiten ne Tabelën 3, shtojca bashkëlidhur. Referuar kësaj tabele, për vitin 2017-2018, personeli akademik i përfshirë në këtë program përbëhet nga 19 PAE dhe 14 PAK. Në përqindje personeli efektiv përbën 58% të personelit akademik të programit. Nga analiza e orëve dhe krediteve që stafi efektiv mbulon, informacion i siguruar ne tabelën 10 dhe tabelën 13, në aneksin bashkëlidhur këtij raporti, rezulton se 76% e tyre mbulohen nga personeli akademik efektiv dhe 24% mbulohen nga personeli akademik joefektiv.

Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet midis tyre paraqiten në Tabelën 4, shtojca bashkëlidhur. Nga analiza qe GVJ i ben kësaj përbërje rezulton se 53% e personelit akademik efektiv të përfshirë në program janë me tituj akademike ose grade shkencore, ndërsa 47% e PAE janë pa grade shkencore. Në nivel programi, 61% e personelit akademik, janë me tituj akademike ose grade shkencore, ndërsa 39% e personelit akademik janë pa grade shkencore. GVJ konkludon se numri i stafit akademik efektiv me grada e tituj dhe raporti Personel Akademik Efektiv/ personel Akademik me kontratë, jane përmirësuar.

### b. AU e ka plotësuar kryesisht kete rekomandim

GVJ konstatoi gjate vizites ne institucion dhe informacionit te siguruar nga kjo vizite, se ngarkesa mesimore eshte e percaktuar qartesisht dhe ne menyre te detajuar per cdo pedagog si dhe per cdo program studimi, perfshi ketu edhe programin e studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi. [Evidence 13. Ngarkesa mesimore per cdo program.pdf, Evidence 14. Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion]. Nga keto evidenca , identifikohet se anetar te stafit qe mbajne pozicione drejtuese, kane edhe nje ngarkese realtivisht me te larte se pedagoget e tjere dhe qe jane te angazhuar ne 5 lende, ne 6 programe mesimore. Persa me siper institucioni, duhet te siguroje nje shperndarje me te harmonizuar te ngarkeses dhe ne perputhje edhe me ngarkesen administrative dhe funksionet e tjera qe stafi mban.

### c. AU e ka plotësuar kete rekomandim

GVJ nga nformacioni i siguruar nga përfaqësues te zyrës se Karrieres si dhe nga takimet me studente, konstaton se institucioni organizon me pjesëmarrjen edhe te studenteve, te aktiviteteve te tilla si leksione te hapura, seminare, workshope si dhe konferenca studentore [Evidence, 35.1 Kalendari i Aktiviteteve Zyra e Karrieres (1).PDF, Vizita ne institucion]

# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

GVJ, referuar RVB, informacionit të siguruar përmes sistemit AMS te ASCAL, gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë baze, përgjegjes për programin e studimit, konstaton se misioni i programit të studimit Bsc. në “Menaxhim Biznesi”, pranë AU, është përgatitja e individëve të kualifikuar për të punuar në sektorin privat, publik dhe organizata jo-fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional dhe shkencor. Misioni i programit konstatohet se është në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të ‘Albanian University’, të deklaruar në statutin e tij, me standardet ndërkombëtare, si edhe me objektivat dhe risitë që synon të sjellë ky program studimi. [Evidence 9, 2.2.Statuti i Albanian University.pdf, Dosja e vetevleresimit]

Përsa i përket qëllimit të këtij programi studimi theksojmë se është informimi dhe studimi i kombinuar i metodave bashkëkohore të administrimit, duke u pajisur me njohuri teorike e praktike rreth shkencës së menaxhimit për përdorimin e këtyre dijeve në të gjitha nivelet e menaxhimit si dhe në të gjitha fushat e ekonomisë dhe biznesit.

GVJ duke iu referuar rregullores së programit, konstaton se objektivat specifike të Bcs. në “Menaxhim Biznesi”, rrjedhin nga zberthimi i qëllimit kryesor dhe të misionit të këtij programi studimi dhe janë si e poshte [Evidence 3, 1.1.Rregullore e programit të studimit BSc në Menaxhim Biznesi.pdf, Dosja e vetevleresimit]:

- Përgatitja e studentëve me metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit,
- Formimi i studenteve me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në fushën e biznesit dhe aftësi të veçanta në menaxhim,
- Formesimi i tyre me parimet etike të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale e financiare.

Programi i studimit Bachelor në “Manaxhim Biznesi”, pranë “Albanian University”, implementohet nga departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE). Referuar kurrikules së këtij programi i studimi, konstatohet se është ndërtuar duke pasur parasysh kërkesat e Kartës së Bolonjës, “Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve” (ECTS) i cili mundëson transferimin e krediteve mes Universiteteve.

GVJ, vlerëson se institucioni, ka hartuar strategjitë në nivel institucional, në nivel njësie kryesore dhe në nivel departamenti, duke synuar orientimin e kësaj strategjie drejt implementimit dhe drejt përmbushjes së objektivave të deklaruara [Evidence 5, 1.3.Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022.pdf; Evidence Plani Strategjik i Fakultetit.pdf; Evidence Plani Strategjik i Departamentit.pdf, Dosja e Vetevleresimit]

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin AMS, konstaton se programi i studimit, Bachelor në Menaxhim

<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Biznesi, pranë AU, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, të deklaruar në statutin e tij [Evidence 9, 2.2.Statuti i Albanian University.pdf, Dosja e vetevleresimit]</p> <p>Duke iu referuar rregullores së programit të studimit, GJV konstatoi se ky program ka të deklaruar objektivat me fokus dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët gjatë ndjekjes së këtij programi [Evidence 3, 1.1.Rregullore e programit të studimit BSc në Menaxhim Biznesi.pdf, Dosja e vetevleresimit]</p> <p>Konstatohet se institucioni ka kryer në vitin 2016 një studim tregu rreth pozicionimit të të diplomuarave në tregun e punës [Evidence 6, Studim i tregut për të diplomuarit.pdf ], gjithësesi GJV sugjeron që ky studim të jetë më i strukturuar, për të reflektuar prioritetet dhe kërkesat e tregut të punës në kurrikulat e programit.</p> <p>GJV referuar objektivave të PS Bsc në Menaxhim Biznesi si dhe përmbajtjes së kurrikules së tij konstaton se ky PS është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojës që kanë organizatat publike dhe private për manaxhere [Evidence 30, 7.3, Kurrikula Bsc. Menaxhim Biznesi.pdf, Arkive].</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>GJV referuar strategjise së institucionit, asaj të fakultetit dhe të njesise baze, përgjigjese për këto programe studimi, konstaton se PS Bsc në Menaxhim Biznesi, është mbështetur në prioritetet strategjike që ky institucion deklaroi si: mesmidhenia, mesimnxenia dhe kurrikulat me në qendër studentin. [Evidence 5, Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2017-2022.pdf, Arkive]</p> <p>Referuar objektivave që programi ka, fokusi i këtij programi konstatohet të jetë përgatitja e studentëve me metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit; Formimi i studenteve me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në fushën e biznesit dhe aftësi të veçanta në menaxhim; Formesimi i tyre me parimet etike të menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale e financiare. [Evidence 3, 1.1.Rregullore e programit të studimit BSc në Menaxhim Biznesi.pdf, Dosja e vetevleresimit]</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b></p> <p><b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e</p>	<p>Duke qenë se struktura e bizneseve shqiptare është e fokusuar kryesisht në bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë pamjaftueshmëri të aftësive manaxheriale për t'i drejtuar këto biznese, GJV është i mendimit se PS Bsc. në "Menaxhim Biznesi", synon të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit</p>

<p>ndërkombëtar;</p> <p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritsëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>ekonomik kombëtar.</p> <p>Referuar studimit të pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës, GVJ konstaton se në këtë studim tregu AU ka përfshirë mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar si dhe perceptimet e punëdhënësve. [Evidence 6, Studim i tregut për të diplomuarit.pdf].</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Referuar Kurrikules së PS, objektivave të tij si dhe strategjive të niveleve të ndryshme të AU, konstatohet si GVJ se PS nuk bie ndesh me interesat kombëtare, [Evidence 7.3 Kurrikula Bsc Menaxhim Biznes.pdf, [Evidence 5, Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit 2017-2022.pdf, Arkive]</p> <p>Referuar takimeve me GVB si dhe me drejtues të institucionit, GVJ konstaton se PS, Bsc. në "Menaxhim Biznesi" i ofruar nga "Albanian University", demonstron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit dhe në përputhje me politikën kombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Referuar analizës së paraqitur më sipër, konkludohet se :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i Studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi është në përputhje me misionin dhe qëllimin e AU dhe me strategjinë për zhvillim të institucionit.</li> <li>- Programi i Studimit Bsc. në "Menaxhim Biznesi" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës me menaxherë biznesi;</li> <li>- PS Bsc. në "Menaxhim Biznesi" ruan vlerat kulturore kombëtare dhe interesat kombëtare</li> </ul> <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se <b>standardet e kësaj fushe janë permbushur</b></p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit*

Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, është fakulteti përgjegjës për programin Bsc. në "Menaxhim Biznesi".

Referuar *Evidences VKA nr.117, dt.18.12.2015.pdf*, FSHAE është krijuar në vitin 2015 nga bashkimi i Fakultetit të Ekonomisë me Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierive me vendim të Këshillit të Akreditimit

të Arsimit të Lartë Nr. 117, datë 18.12.2015 dhe Urdhër të Ministrit Nr. 52, datë 05.02.2016 [Evidencë .UM nr.52, dt.05.02.2016.pdf].

GVJ bazuar mbi informacionin e siguruar nëpërmjet sistemit AMS, konstaton se struktura organizative e FSHAE përbëhet nga tre njësi baze:

- Departamenti i Arkitekturës, që përbëhet nga 40 pedagogë ndër të cilët, 21 PAE dhe 19 PAK
- Departamenti i Inxhinierive, që përbëhet nga 37 pedagogë ndër të cilët, 23 PAE dhe 14 PAK
- Departamenti i Shkencave Ekonomike, që ka në përbërjen e tij 51 pedagogë, ndër të cilët 28 janë personel akademik efektiv dhe 23 personel akademik me kontrate [Evidence, Organograma 2017.pdf, Arkive]

Referuar Tabelës 1 ne shtojcën bashkëlidhur, FSHAE ka 72 PAE dhe 56 PAK.

Duke iu referuar RVB dhe të dhënave institucionale në sistemin AMS, konstatohet se gjatë periudhës 2009-2018, struktura organizative e FSHAE ka pësuar ndryshime dhe është ristrukturuar. Kështu, gjate 2009-2010 njësi bazë përgjegjëse për këtë program ishte departamenti i Financë-Bankës, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara; në periudhën 2010-2014 njësi bazë përgjegjëse për këtë program ishte departamenti i Administrim Biznesit, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë (VKA nr. 299, datë 13.01.2012) dhe nga 2015 e në vazhdim pas riorganizimit të Universitetit në tre Fakultete, njësi bazë përgjegjëse per Bsc.në Menaxhim Biznesi është Departamenti i Shkencave Ekonomike pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike [Evidence, H.2.b.UM nr.52, dt.05.02.2016.pdf, Dosja e vetevleresimit]

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Personeli akademik i njesise kryesore, FSHAE perbehet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personeli akademik i ftuar, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e AU [Evidence 9, 2.2.Statuti i Albanian University.pdf, Dosja e vetevleresimit]

Të drejtat dhe detyrimet e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës, në Rregulloren e Përgjithshme të AU dhe në rregulloren e Fakultetit [Evidencë 12 3.2.a Kontratë pune PAE.pdf; Evidence 10 2.3.Rregullore e Pergjithshme e Albanian University.pdf; Evidence 8, 2.1.Rregullore e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike.pdf, Dosja e vetevleresimit].

Referuar RVB si dhe informacionit te siguruar nga takimi me drejtues te njësisë baze, konstatohet se departamenti i Shkencave Ekonomike është organizuar sipas grup lëndëve, ku identifikohen:

- Grup-lëndët e formimit bazë;
- Grup-lëndët e Manaxhimit;
- Grup-lëndët e Financë-Kontabilitetit;
- Grup-lëndët e Ekonomiksit;
- Grup-lëndët e Statistikë-Matematikë;

Referuar kësaj strukture, GVJ mendon se ajo është në funksion të programit të studimit, të përmbushjes së objektivave si dhe të implementimit të strategjisë që institucioni, ka për këtë programi studimi. Ndarja në grup lëndë e përforcon konstatimin e mësipërm.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Ne lidhje me stafin akademik te departamentit përgjegjës per programin e studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi, referuar shqyrtimit të të dhënave të siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se personeli



akademik i Departamentit të Shkencave Ekonomike, përbëhet nga 51 pedagogë, ndër të cilët 28 PAE dhe 23 PAK, ose të shprehur në përqindje, 55% janë personel efektiv dhe 45% personel akademik me kontratë.

Në përbërje të stafit efektiv të DSHE, 57% e PAE janë me tituj akademike ose grada shkencore, ndërsa 74% e PAK janë me tituj akademike ose grada shkencore. [Evidence, Tabela 2, shtojca bashkelidhur]. Të dhënat më sipër i përkasin vitit akademik 2017-2018, vit për të cilin bëhet akreditimi për këtë program studimi.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Për këtë fushë, GVJ nuk kërkoi dhe nuk siguroi të dhëna shtesë gjatë vizitës në institucion

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.*

GVJ në lidhje me personelin akademik dhe mbështetës të programit të studimit Bsc. në “Menaxhim Biznesi”, duke analizuar informacionin e siguruar nga takimet, gjatë vizitës në institucion si dhe RVB, konstaton se personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor por edhe shërbime dhe detyra administrative, ndërkohë që stafi joakademik mbulon aktivitete administrative dhe mbështetëse, në funksion të kërkesave të stafit akademik dhe studentëve për funksionimin e programit të studimit, sipas përcaktimeve në Statutin e AU dhe rregulloreve perkatëse mbi të cilat ky program studimi funksionon. [Evidencë 12 3.2.a Kontratë pune PAE.pdf; Evidence 10 2.3.Rregullore e Pergjithshme e Albanian University.pdf; Evidence 8, 2.1.Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.pdf, Dosja e vetevleresimit].

GVJ gjatë vizitës inspektuese në institucion, dhe konkretisht në zyrën e burimeve njerëzore konsultoi disa kontrata punë të personelit akademik efektiv dhe joefektiv. Nga ky takim konstatohet se në keto kontrata specifikohen qartësisht dhe janë të percaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve, kohëzgjatja e kontratës, koha e pushimit, benefitet financiare, lëndet që ata do të mbulojnë dhe programin e studimit ku përfshihen si dhe mënyrat e zgjidhjes së kontratës. [Evidence, 3.2.a Kontratë pune PAE.pdf, Evidence, 3.2.b Kontratë pune PAK.pdf, Dosja e vetevleresimit]

Përveç analizës së kontratave të punës, GVJ shqyrtoi dhe disa procedura rekrutimi të personelit efektiv dhe joefektiv në kete program studimi, për vitin 2017-2018. Konstatohet se përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik PAE dhe PAK, behet bëhet nëpërmjet konkursit dhe nëpërmjet një procedure të shpalljes së vendeve vakant, në faqen zyrtare të AKP, të AU, si dhe në media vizive. Ky proces seleksionimi starton në departament, i cili pas një analize të kapaciteteve dhe ngarkesave, konstaton nevojën për personel të ri akademik, paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në dekanat, i cili nga ana e tij i percjell kërkesat në nivel njësie kryesore rektoratit. Rektorati përcakton kriteret dhe procedurat e konkurimit. Kriteret e rekrutimit janë të deklaruara, dhe ashtu sikundër paraqitet edhe në RVB ato janë:

- Përfundimi i ciklit të dytë të studimeve në profilin përkatës, sipas lëndës që do të mbulojnë, me mesatare mbi 8 (tetë);
- Të kenë së paku gradën shkencore “Doktor” ose PhD;
- Eksperiencia në mësimdhënie dhe eksperiencë profesionale, e lidhur me lëndën/ët që do të mbulojnë;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme personale për vendin e punës;

- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;

Pra ashtu sic shihet edhe nga informacioni i deklaruar ne RVB, kërkohet që stafi të ketë mbaruar së paku studimet doktrale dhe të mbajë gradën shkencore PHD, por GVJ konstatoi se ky kusht, jo gjithmonë ishte respektuar gjatë procedurave te rekrutimit, ndërkohë që janë rekrutuar stafe pa gradën shkencore.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Nga te dhënat e siguruar nga institucioni, ne lidhje me stafin akademik te perfshire ne mësimdhënie ne programin e studimit Bsc. në “Menaxhim Biznesi”, rezulton se për vitin akademik 2017-2018, në këtë program janë përfshirë 33 pedagogë. Keto te dhëna paraqiten ne Tabelën 3, shtojca bashkëlidhur.

Referuar kësaj table, për vitin 2017-2018, personeli akademik i përfshirë në këtë program përbëhet nga 19 PAE dhe 14 PAK. Në përqindje personeli efektiv përbën 58% të personelit akademik të programit. Nga analiza e orëve dhe krediteve që stafi efektiv mbulon, informacioni i siguruar ne tabelën 10 dhe tabelën 13, në aneksin bashkëlidhur këtij raporti, rezulton se 76% e tyre mbulohen nga personeli akademik efektiv dhe 24% mbulohen nga personeli akademik joefektiv.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 4 në Aneks)

Të dhënat për kualifikimin e stafit dhe raportet midis tyre paraqiten në Tabelën 4, shtojca bashkëlidhur. Nga analiza qe GVJ i ben kësaj përbërje rezulton se:

- 53% e personelit akademik efektiv të përfshirë në program janë me tituj akademike ose grade shkencore, ndërsa 47% e PAE janë pa grade shkencore.
- 72% e personelit akademik me kontrate janë me tituj akademike ose grade shkencore, ndërsa 28% e PAK janë pa grade shkencore.

Në nivel programi, 61% e personelit akademik akademik, janë me tituj akademike ose grade shkencore, ndërsa 39% e personelit akademik janë pa grade shkencore.

- Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat 5 dhe 6 në Aneks)

Të dhëna për përbërjen moshore të stafit akademik, të përfshirë në këtë program studimi, paraqiten në Tabelat 5 dhe 6 në shtojcë. Referuar këtyre tabelave 57% e stafit akademik efektiv janë në moshën 25-35, 21% në moshën 35-45 vjec, 11% në moshën 55-65 vjec, 5% në moshën 45-55 vjec, dhe 6% në moshën 65-68.

Të dhënat për personelin akademik me kontratë jepen në Tabelën 6, nga ku konstatojmë mbizotëron intervali 35-45 vjec me 43% të PAK. Pjesa tjetër është e shpërndarë në intervalet e tjera moshore. Pra, ka nje shpërndarje te harmonizuar të moshave tek të dy kategoritë e stafit akademik, PAE dhe PAK.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjate vizitës ne institucion, u siguruan informacione per praktikat e rekrutimit, kontratat e punës, ngarkesën mesimore të personelit akademik të programit, listën e pedagogëve të përfshirë në programin e studimit që vlerësohet.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga vizita ne institucion vlen te theksohet se GVJ konstatoi korrektese, pergjegjshmeri dhe mbajtje te rregullt te informacionit dhe te kryerjes se procedurave ne lidhje me programin.

### Vleresimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b> <b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dhe disa procedura rekrutimi te personelit akademik efektiv dhe me kontratë në këtë program studimi, për vitin 2017-2018. Konstatohet se përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik PAE dhe PAK, behet nëpërmjet konkursit dhe një procedure të shpalljes së vendeve vakant, në faqen zyrtare të AKP, të AU si dhe ne media vizive. Ky proces seleksionimi starton në departament, i cili pas një analize të kapaciteteve dhe ngarkesave, konstaton nevojën për personel të ri akademik, paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në dekanat, i cili nga ana e tij i percjell kërkesat në nivel njësie kryesore rektoratit. Rektorati përcakton kriteret dhe procedurat e konkurimit. <i>[Evidence, 24.1 Printscreen shpallja e vendeve vakante.pdf, vizita ne institucion]</i></p> <p>Referuar RVB, ndër kriteret kryesore te rekrutimit të personelit akademik janë përfundimi i ciklit të dytë të studimeve në profilin përkatës, sipas lëndës që do të mbulojnë me mesatare mbi 8 (tetë) dhe kandidatet të kenë së paku gradën shkencore “Doktor” ose PhD etj.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në PS Bsc. ne “Menaxhim Biznesi”, përbën 58 % të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Nga analiza e shpërndarjes së ngarkesës sipas planit mesimor mes PAE dhe PAK, rezulton se personeli akademik efektiv mbulon 76% te ngarkeses mesimore ne kete program studimi. <i>[Tabela 10, Tabela 13, shtojca bashkelidhur]</i></p> <p>Nga dokumentacioni i siguruar gjate vizites ne institucion, GVJ vlerëson se AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit, të cilat perfshijnë disa forma vlerësimi, si vetëvlerësimi, vlerësimi nga drejtuesi i njësisë bazë, vlerësim nga studentët. <i>[Evidence, 3.3.b.Model Pyetesori Studenti.pdf; Evidence 13, Formular Vleresimi nga Drejtuesi i Departamentit per PAE dhe PAK .pdf, Evidence 31.1 Formular vetevleresimi PAE, Vizita ne institucion]</i></p> <p>GVJ nga informacioni i siguruar nga vizita pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, konstatoi se kjo zyrë mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, te komisioneve te ngritura, te vendimeve te marra prej tyre per vitin akademik 2017-2018.</p>

**Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

**Kriteri 2** Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;

**Kriteri 3** Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;

**Kriteri 4** Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor,, ose titullin akademik "Docent,,.

GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se AU disponon një bazë të dhënash për personelin akademik të përfshirë në PS Bsc. në "Manaxhim Biznesi". Nga ky dokumentacion, sigurohet informacion për lektorët, lëndet, orët mesimore, semestri etj. [Evidence 13. Ngarkesa mesimore per cdo program.pdf, Evidence 14. Tabela e ngarkeses individuale per cdo pedagog.pdf, Vizita ne institucion]

Në ankesin e kontratës së personelit akademik konstatohet se përcaktohen përveç informacioneve të tjera, edhe lëndët që do të mbulojë, programi i studimit si dhe përfshirja në mësimdhënie e leksioneve dhe/ose seminareve.

GVJ konstaton se AU përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Këto kritere sipas informacionit të siguruar në Zyrën e Burimeve Njerezore, publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit, në faqen zyrtare të AU si dhe në media vizive [Evidence 24.1 Printscreen shpallja e vendeve vakante.pdf, Vizita ne institucion]

Nga tabela 13 në shtojcën bashkelidhur konstatohet se titullaret e moduleve të programit Bsc. në "Menaxhim Biznesi" kanë të paktën gradë shkencore.

**Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;

**Kriteri 3** Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

Referuar kurrikules së programit Bsc në "Menaxhim Biznesi" konstatohet se ky program nuk ka orë laboratorike. [Evidence 4, Kurrikula Bsc.ne Menaxhim Biznes.pdf, Dosja e vetevleresimit], pavarësisht kësaj, personeli i Zyrës së IT-së është i angazhuar në mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike në auditore, si pjesë e infrastruktures mësimdhënëse.

GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi disponibilitet dhe saktësi në kryerjen e procedurave dhe në mbajtjen e rregjistrimeve. Referuar strukture së AU, si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në AU funksionojnë Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit të cilat janë në mbështetje të përmbushjes së objektivave të PS Bsc në "Menaxhim Biznesi".

AU dëshmon se ka një përdorim optimal të burimeve njerëzore, e cila u demonstrua nga personeli administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor edhe gjatë vizitave në institucion.

Referuar takimit me GVB, rezultoi se për menaxhimin e praktikave në PS Bsc. në "Menaxhim Biznesi" një pedagog, mund të udhëheqë maksimalisht 10 studentë.

**Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik te programit si dhe drejtues te njesise kryesore, konstatohet se AU ka organizuar 3 trajnime, për metodologjinë e mësimdhënies, për kurrikulën e bazuar mbi kompetenca si dhe për edukimin në vazhdim, trajnime këto të orientuara për personelin akademik [Evidence 3.4.Trajnimet e Brendshme.pdf, Dosja e vetevleresimit]</p> <p>GVJ sugjeron që në të ardhmen të intensifikohet përfshirja e personelin në trajnime të vazhdueshme dhe që i shërbejnë në mënyre të drejtpërdrejte personelit të njësisë bazë që shkojnë përtej mesimdhënies, si p.sh për metodologjitë e kërkimit shkencor si dhe atyre të shkrimit dhe aplikimit për projekte, etj</p> <p>Nga takimi me përfaqësues të Zyres së Kurrikulave, konstatohet se AU disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve në format elektronik dhe hardcopy, dhe që ruhet pranë Departamentit dhe Zyres për Zhvillimin e Kurrikulave.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- AU ndjek procedura transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit</li> <li>- AU disponon një bazë të dhënash për personelin e programit Bsc. në “Menaxhim Biznesi”</li> <li>- AU angazhon personel ndihmës mësues shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij</li> <li>- Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij</li> </ul> <p><b>Per sa me sipër GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen</b></p> <p><u>Rekomandime:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ sugjeron që në të ardhmen të intensifikohen përfshirja e stafit në trajnime të vazhdueshme dhe që i shërbejnë në mënyre të drejtpërdrejte personelit të njësisë bazë, që shkojnë përtej mesimdhënies, si p.sh për metodologjitë e kërkimit shkencor si dhe atyre të shkrimit dhe aplikimit për projekte, etj</li> </ul>	

#### 4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.*

Referuar RVB, informacionit në sistemin AMS si dhe konstatimeve gjatë vizitës në mjediset e ‘Albanian University’, rezulton se AU disponon 4 godina në funksion të programeve të studimit që ky institucion ka. Lokacioni i AU është në qendër të kryeqytetit dhe pranë godinave të karakterit rezidencial apo të shërbimeve të tjera alternative për komunitetin studentor. Departamenti i Shkencave Ekonomike ndodhet në godinën qendrore në Bulevardin “Zogu I”, me një sipërfaqe prej 3996 m<sup>2</sup> [Evidence, 4.1 Planimetria e godines.pdf, Dosja e Vetevleresimit].

Ndërtesa ku Departamenti i Shkencave Ekonomike zhvillon proceset akademike dhe administrative, është një godinë egzistuese, e cila është rikonstruktuar dhe është përshtatur në auditore për mesimdhënien dhe në ambiente zyrash dhe shërbimesh administrative. Auditorët janë të pajisura me video projektor dhe kompjuter. Të gjitha ambientet e kësaj godine mbulohen me internet.

Salla e bibliotekës disponon një numër të limituar postesh leximi, me një numër të vogël kompjuterash, dhe në një hapësirë e cila ka nevojë të përmiresohet, persa i përket kushteve fizike dhe ndriçimit. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të kërkimit të pedagogëve. Shërbimi i bibliotekës, realizohet prej punonjësve të saj dhe ofrohet për stafin akademik dhe studentët. Studentet regjistrohen përmes kartës së regjistrimit dhe mund të aksesojnë literaturë si në gjuhën shqipe dhe ato në gjuhë të huaj në ambientet e bibliotekës.

GVJ, nga vizita në mjediset e bibliotekës, konstatoi se numri fizik i kartelave të studenteve të programeve të studimit të fushës së ekonomisë paraqitet i vogël, krahasur me numrin e studentëve të regjistruar në këto programe.

Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projekteve kërkimore-shkencore. Literatura profesionale është kryesisht në gjuhën angleze dhe shqipe. Referuar RVB, në fondin e bibliotekës numërohen rreth 1200 libra të titujve të ndryshëm.

Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe bazë, konstatohet se njësia baze për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor, paraqet kërkesa të përvitshme [*Evidence, 4.2.Kerkese e Departamentit per fondin e bibliotekes.pdf*]. Gjithashtu u konstatua se stafi akademik dhe studentët kanë mundësi aksesimi në bibliotekën elektronike, QUESTIA pa pagesë, në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

AU boton revisten shkencore OPTIME - në të cilën botohen të gjithë punimet shkencore në kuadër të përmbushjes së kërkesave për kërkime dhe punime shkencore në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve sipas fushave të ndryshme, në të cilat AU ka programe studimi. Gjithashtu 'Albanian University Press', - ndërmarrja botuese pjesë e "Albanian University, ka botuar të gjithë librat në kuadër të përmbushjes së kërkesave për tekste mësimore dhe shkencore në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve. AU ofron edhe shërbime të tjera mbështetëse, sic është shërbimi i fotokopjes që ndodhet në librarinë e universitetit dhe mund të përdoret nga studentët dhe pedagogët.

Kanali televiziv kombëtar UTV - pjesë e "Albanian University", i shërben promovimit të institucionit dhe programeve të tij të studimit si dhe zgjerimit të spektrit të tyre të dijeve dhe përvetësimit të informacioneve të reja, në lidhje me drejtimit ku ata studiojnë.

AU disponon Sallen e Konferencave, e pajisur me teknologji multimediale, audio dhe video, për realizimin e konferencave dhe aktiviteteve të tjera të këtij standardi.

Në këtë godinë janë të integruara edhe një tërësi shërbimesh të tjera si kafeteri/fast-food, si dhe vetëshërbimi ushqimor për të gjithë studentët e AU dhe që konsiderohet facilitet për studentet.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Mjediset për Programin e studimit (Tabela 7 në Aneks)

Të dhëna për mjediset në dispozicion të programeve të studimit që AU ka paraqiten në tabelën 7, në shtojcën bashkëlidhur. AU dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programit të studimit, të përbërë nga 10 salla leksionesh, 20 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjësin e njësisë bazë etj. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme dhe kompjutera, për zhvillimin normal të procesit mësimor. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për programin e studimeve.

Mjediset për stafin

Te dhënat me poshtë janë marre nga Tabela 7, në shtojcën bashkëlidhur, referuar te dhënave të siguruar nga RVB dhe të verifikuara gjatë vizitës në institucion

- Mjedise për Dekanin 1
- Zyra për sekretarinë mësimore 2
- Zyra për departamentet 1
- Zyra për personelin akademik 1

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ referuar informacionit të siguruar gjatë vizitës në AU, takimeve me drejtues të njësisë bazë, konstaton se institucioni, siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në dispozicion të PS Bsc ne MB. GVJ sugjeron që kjo literaturë të përditësohet me botimet e fundit të fushave respektive si dhe te shtohet fondi i librave hard copy [Evidence, 4.3. Lista e teksteve per programet ne Shkencat Ekonomike.pdf]</p> <p>GVJ, konstaton nga informacioni, i marrë gjatë vizitës në institucion, se biblioteka e AU, ka literaturë që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, por GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore dhe të azhornuar të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që PS Bsc.MB përmban.</p> <p>Referuar <b>informacionit</b> të siguruar gjate vizitës në institucion, GVJ konstaton se në bibliotekën e AU, gjenden botime periodike dhe librari elektronike si <a href="http://www.questia.com">www.questia.com</a>, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme, për realizimin e programit të studimit</p> <p>GVJ, konstaton nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, takimeve me përgjigjësën e njësisë bazë dhe GVB, se përgjigjësi i PS Bsc. ne MB dhe pedagogët, janë të angazhuar për pajisjen e bibliotekës me tekstet mësimore dhe literaturës së azhornuar duke paraqitur kerkesa te përvitshme për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit [Evidence, 4.2.Kerkese e Departamentit per fondin e bibliotekes. pdf]</p> <p>Referuar GVB, informacionit të siguruar nga studentët dhe nga personeli i bibliotekës gjatë vizitës në institucion, biblioteka, si njësi ndihmëse, i shërben aktivitetit mësimor në përshtatje me oraret dhe nevojat e studentëve.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mesimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

**Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistike, linguistike, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.

**Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

GVJ konstatoi se AU ka salla leksionesh dhe seminaresh të mjaftueshme për të përballuar nevojat e programit të studimit Bsc. Menaxhim Biznesi. Keto salla janë të pajisura me kompjuter dhe videopjektor, për realizimin e programit të studimit

AU referuar tabelës 7 në shtojcën bashkëlidhur, dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programit të studimit, të përbërë nga 10 salla leksionesh, 20 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjësinë e njësisë bazë etj. [Tabela 7 shtojca bashkëlidhur]. GVJ referuar këtyre të dhënave, sugjeron zgjerim të ambienteve për personelin akademik të departamentit, duke qenë se ky departament ka ardhur duke u zgjeruar në vite dhe aktualisht ka 28 pedagoge, ndërkohë që nga RVB, raportohen 2 zyra, 1 për departamentin dhe 1 për personelin akademik të departamentit, të konsideruara të pamjaftueshme për akomodim të një personeli të tillë.

AU në godinën ku zhvillohen proceset mesimore të PS Bsc në Menaxhim Biznesi, ka 1 laborator informatike me kapacitet prej 30 personash, dhe që përdoret për lëndën Informatike.

Pavarsisht, se sipas një skedulimi normal të orarit të punës, laboratori ka mundësi që t'ju shërbejë disa programeve të studimit, GVJ sugjeron shtim të laboratoreve dhe kapaciteteve kompjuterike në këto godine, duke qenë se këtu zhvillojnë proceset mesimore disa fakultete dhe shumë programe studimore të nivelit master dhe bachelor në kurrikulat e të cileve, përdorimi i laboratoreve është domosdoshmeri.

GVJ konstaton se praktikën, nuk zhvillohen në ambientet e AU por pranë institucioneve dhe kompanive të biznesit me të cilat AU ka marrëveshje. Rezulton se janë 22 organizata me të cilat AU ka marrëveshje dhe që disponojnë kapacitete të mjaftueshme për të pritur studentët për praktika. [Evidenca 11.2. Marrëveshje bashkëpunimi me organizata dhe biznese.pdf, Vizita në institucion]

#### **Konkluzione të GVJ:**

- AU vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij. Fondi i bibliotekës duhet të pasurohet me botimet e fundit të fushave respektive që lidhen me PS Bsc. në Menaxhim Biznesi.
- AU vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mesimore dhe për formimin praktik, por AU duhet të shtojë laboratorët, pasi deri tani ka vetëm 1 laborator, ku zhvillojnë proceset mesimore disa fakultete dhe shumë programe studimore të nivelit master dhe bachelor.

**GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe konsiderohen kryesisht të përmbushura**

Rekomandime:



- GVJ sugjeron që AU të intensifikoje përpjekjet për përditesimin e literaturës dhe shtimin e fondit të bibliotekës, me botimet e fundit të fushave respektive që lidhen me programin e studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi
- GVJ sugjeron shtim të ambienteve për stafin akademik të departamentit, duke qenë se ky departament ka ardhur duke u zgjeruar në vite dhe mjediset aktuale të parashikuara për këtë staf, konsiderohet të pamjaftueshme për funksionimin normal.
- GVJ sugjeron shtim të laboratoreve dhe kapaciteteve kompjuterike në godinën kryesore, duke qenë se këtu zhvillojnë proceset mësimore disa fakultete dhe shumë programe studimore të nivelit master dhe bachelor, kur deri tani në dispozicion të të gjithë këtyre programeve është vetëm 1 laborator.

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.*

Në AU ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre. Sipas RVB dhe informacionit të siguruar gjatë takimit të zhvilluar me GVB, AU ka një raport financiar për çdo vit buxhetor që miratohet nga ekspertë të jashtëm.

GVJ vlerëson praktikën e ndjekur nga institucioni, që përveç certifikimit të pasqyrave financiare nga audituesi i pavarur, AU ka në strukturën e vet edhe zyrën e auditit të brendshëm që realizon kontrollin dhe auditimin e brendshëm që funksionon pranë Zyrës të Financës dhe dhe varet nga Bordi i Administrimit.

Referuar Tabelës 8 në shtojcën bashkëlidhur, të siguruar nga RVB, institucioni paraqet të ardhurat dhe financimet për vitin fiskal 2017, pasi të dhenat për vitin fiskal 2018, nuk mund të raportohen, përpara mbylljes së vitit ushtrimor. Këto të ardhura, janë siguruar nga të ardhurat nga tarifat e shkollimit si dhe nga aktivitetet tregëtare.

Për vitin 2017-2018, 99.5% e të ardhurave vijnë prej tarifave të shkollimit, dhe 0.5% vijnë nga shërbimet tregëtare.

Raporti i hollësishëm i auditit sipas informacionit të siguruar nga GVB, është i disponueshëm në Zyrën e Financës të AU, ndërkohë që një përmbledhje e këtij dokumentacioni iu vendos GVJ në dispozicion, mbas kërkesës së bere gjate vizites ne institucion, nëpërmjet sistemit AMS. [Evidence 10, Raporti i Auditit të Jashtëm.pdf, Vizita ne institucion]

GVJ vlerëson si praktikë, heqjen e tarifës së regjistrimit për të gjithë studentët dhe mos aplikimi i tarifave të tjera shtesë për provimet në sesionin e parë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
  - AU **nuk** ka të ardhura nga grantet për kërkim për vitin 2017
  - Konsulencat, shërbimet, donacionet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2017.
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit kanë siguruar 99.5% të të ardhurave gjate, 2017
  - Sponsorizimet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2017.

- Shërbimet trainuese **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2017.
- Donacionet, aktivitetet siguruese etj **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë 2017.
- Aktivitetet tregtare kanë siguruar 0.5 % të ardhurave gjatë 2017

GVJ konstaton nga analiza e shifrave të Tabelës 8 dhe nga përqindjet e siguruara, se kryesisht të ardhurat per AU, realizohen ne masën mbi 99.5% per te gjithë periudhën e akreditimit, nga tarifat e studimit. Grantet, projektet, donacionet dhe konsulentat nuk sigurojnë te ardhura.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Referuar RVB dhe informacionit të siguruar gjatë takimit me GVB, konstatohet se shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Kostoja e raportuar nga institucioni për një student në programin e studimit Bsc. në "Menaxhim Biznesi", llogaritet 125000 lekë/për vit akademik.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion GVJ paraqiti kërkesen për informacion mbi raportet e auditimit të AU. Ky informacion për vitin fiskal 2017, u vu në dispozicion nga institucioni, dhe u konsultua nga GVJ përmes sistemit AMS.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Gjatë vizites ne institucion GVJ paraqiti kerkesen per informacion mbi raportet e auditimit te AU. Ky informacion per vitin fiskal 2017, u vu ne dispozicion nga institucioni, dhe u konsultua nga GVJ permes sistemit AMS. Referuar RVB ketij dokumenti, AU ka raport auditit i cili eshte miratuar nga eksperti i jashtem. [Evidence 10, Raporti i Auditit te Jashtem.pdf, Vizita ne institucion]</p> <p>Opinion i auditit, qe iu vendos ne dispozicion GVJ-se, gjate vizites ne institucion, shprehet se pasqyrat financiare te AU, paraqesin ne menyre te drejte ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te shoqerise ne 31 Dhjetor 2017, si dhe rezultatin e operacioneve te saj dhe rrjedhjes se parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. [Evidence 10, Raporti i Auditit te Jashtem.pdf, Vizita ne institucion]</p> <p>Ne lidhje me kete kriter, GVJ referuar tabelave te financiare te siguruara nga institucioni konstaton se AU nuk perfiton financime nga asnjë grant dhe nuk ofron sherbime nga te cilat mund te sigurojne te ardhura</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të</p>	<p>GVJ, konstaton se AU harton raport financiar, me të dhëna mbi të ardhurat, shpenzimet dhe komponentë të tjerë</p>



<p>ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>financiarë. Në të paraqiten burimi i të ardhurave, ku për vitin 2017, 99.5% e të ardhurave garantohej nga tarifat e shkollimit dhe 0.5 % nga të ardhurat nga aktivitetet tregtare. Konstatohet se shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit.</p> <p>Rezultoni se AU ka qëndrueshmëri financiare dhe ka kapacitete financiare për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p>Për të ardhmen GVJ sugjeron diversifikimin e burimeve financiare, jo vetëm nga tarifat e studimit, por edhe nga burime të tjera të tjera të lartpërmendura, të cilat përveçse krijojnë mundësi të tjera financimi, i shërbejnë institucionit edhe në kuadrin e kërkimit shkencor dhe rritjes së kontributit institucional në komunitetin shkencor</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- AU harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</li> <li>- AU bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare dhe të qëndrueshmërisë financiare</li> <li>- Burimi kryesor i financimit, me 99.5 % janë tarifat e studimit dhe deri tani institucioni nuk ka siguruar diversifikim të burimeve të financimit nga grantet, projektet, konsulentat apo donacionet.</li> <li>- GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, <b>konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen kryesisht.</b></li> </ul> <p><b><u>Rekomandime:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>GVJ sugjeron diversifikimin e burimeve financiare, jo vetëm nga tarifat e studimit si deri tani dhe që kanë ardhur duke u zvogëluar, por edhe nga burime të tjera të tjera si grantet, konsulentat, projektet, të cilat përveçse krijojnë mundësi të tjera financimi, i shërbejnë institucionit edhe në kuadrin e kërkimit shkencor dhe rritjes së kontributit institucional në komunitetin shkencor</i></li> </ul>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.*

NJSBC në AU funksionon në bazë të politikave dhe kritereve të përshtatshme duke orientuar dhe monitoruar sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme. NJSBC varet nga Rektori i Universitetit, përgatit raportin vjetor dhe ka për detyrë paraqitjen e një raporti vjetor me vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i paraqitet Senatit akademik dhe publikohet në faqen zyrtare të AU. Njesia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë në AU, referuar dokumentacionit në sistemin AMS, konstatohet se është institucionalizuar me Vendim Senatit Akademik në 23/07/2010. Me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 është ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cili harton politikën e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë në përputhje LAL.

Fuksionet dhe detyrat e NJSBC, parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Universitetit dhe në Rregulloret specifike. NJSBC mbështet, këshillon, bashkërendon, monitoron dhe administron e dhe ofron ekspertizë në proecin e sigurimit të cilësisë.

NJSBC dhe Komisioni për Vlerësim Institucional hartojnë politikat e vetëvlerësimit, përcaktojnë kriteret e vlerësimit, realizojnë anketimet e raportimet, etj.

GVJ nga informacioni i siguruar nepermjet sistemit AMS, nga RVB si dhe nga takimet me perfaqesues te NJSBC, konstaton se NJSBC finalizon aktivitetin e saj me paraqitjen e një raporti vjetor per vlerësimin e procesit te mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Ky raport pasi paraqitet në Senat Akademik, miratohet dhe publikohet në faqen zyrtare te AU. NJSBC ka funksione mbështetëse, këshillimore, bashkërenduese, monitoruese dhe administrative me strukturat e tjera akademike dhe administrative të AU.

Gjatë aktivitetit të vetë NJSBC në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin Institucional, ajo harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. GVJ vlerëson praktiken e ndjekur nga AU që për ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë edhe ne nivel njesie baze qe prej vitit 2016. Në nivel njesie baze, analizohen dhe vleresohen programet mesimore, literaturat dhe format e vleresimit te cilat paraqiten te standardizuara. NJSBC kontrollon dhe vlereson duke u mbeshur mbi nje metodologji që perdor pyetesoret dhe fokus grupet, raportet e vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njësisë bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. GVJ siguroi te dhena rreth ketyre formave te vleresimit, nga informacioni i arkivuar nga institucioni si dhe nga informacioni shtese i siguruar gjate vizites ne institucion. NJSBC ne baze te informacionit primar dhe sekondar, harton raporte te cilat i drejtohen rektorit si dhe senatit akademik. Keto raporte permbajne rezultatet e vleresimit, identifikimin e problematikave si dhe rekomandimet e metejshme.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

GVJ konstaton, nga komunikimi me NJSBC se për vlerësimin e programit të studimeve përdor metoda alternative, ku përvec pyetesoreve organizohen dhe fokus grupe me studentët, për të siguruar informacion shtesë, informacion më cilësor, dhe për të shmangur asimetrinë e informacionit. Pyetesoret rezultojn se aplikohen dy here ne vit, ne përfundim te cdo semestri. Norma e pjesëmarrjes ne këte anketim, ne programin e studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi, eshte 50%.

Gjatë takimeve me NJSBC, GVJ-së iu vendos në dispozicion informacion mbi mënyrën e funksionimit, rregulloren e saj, planin e veprimt, format e pyetesoreve të kryer etj.

Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Mbas njohjes me RVB si dhe takimit me NJSBC, rezultojn se NJSBC ne nivel njesie baze ka ne përbërje të saj 6 anëtarë, të cilët kane ne kete detyre me pak se 2.5 vite [Tabela 9, shtojca bashkëlidhur]

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Ne AU rezultojn se kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nga Komisioni për Vlerësim Institucional (një nga anëtarët e Komisionit është personel akademik efektiv i Departamentit të Shkencave Ekonomike).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjate vizitës ne AU, GVJ-se në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, iu vendosen në dispozicion dokumentat e kërkuar, te cilët u shqyrtuan në funksion të konkluzioneve të nxjerra për këtë rubrike si; *Evidence 39.a shkresë fokus grupe.pdf*; *Evidence 39.b Pergjigje shkresës së shkresës (2).pdf*; *Evidence 40.a Shkresë RV.pdf*; *Evidence 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf*; *Evidence 40.c Rekomandimet RV.pdf*; *Evidence 25. Model pyetesori i gjeneruar nga sistemi.pdf*, *Evidence, 29.1 Formular Vleresimi nga Drejtuesi i Departamentit per PAE Bachelor.pdf*; *Evidence 31.1 Formular vetevleresimi PAE BSc.pdf*, etj

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtëpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtëpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktike;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatat);</li> <li>Vezhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>GVJ konstaton se AU perdor pyetesoret, fokus grupet, vetevleresimet, vleresimet nga pergjegjesi i departamentit si pjese e metdologjise dhe si instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi, [<i>Evidence 25. Model pyetesori i gjeneruar nga sistemi.pdf etj</i>]</p> <p>GVJ konstaton se rezultatet e siguruar nga NJSBC, kjo njesi i përfshin ne raportet vjetore qe realizon, ku identifikohen problematikat dhe paraqiten dhe rekomandimet [<i>Evidence 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf</i>; <i>Evidence 40.c Rekomandimet RV.pdf</i>]</p> <p>Nga vezhgimi i web sitit zyrtar, konstatohet se AU i publikon ne web sitin zyrtar rezultatet e vleresimit ne menyre te permblodhur si dhe pritshmerite per te ardhmen [<i>Evidence 41. Pritshmëritë për v.a. 2018-2019.pdf</i>, <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/</a>]</p> <p>GVJ nga takimet me studentet e programit, drejtues te njesise baze, perfaqesues te NJSBC si dhe me stafin e programit, konstaton se AU perdor per vlerësimin metoda të tërthorta dhe të drejtëpërdrejta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pyetesore me studentet dy here ne vit,</li> <li>Fokus grupe me studentet</li> <li>Vetevleresimit te PAE dhe PAK</li> <li>Vleresimet e drejtuesit te njesise baze per PAE dhe PAK</li> <li>Rezultatet e studenteve ne provimet e lendeve, kalueshmeria, nota mesatare etj</li> </ul> <p>[<i>Evidence 25. Model pyetesori i gjeneruar nga sistemi.pdf</i>; <i>Evidence 31.1 Formular vetevleresimi PAE Bsc.pdf</i>; <i>Evidence 29.1 Formular Vleresimi nga Drejtuesi i Departamentit per PAE Bsc.pdf</i>]</p>
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>AU ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve, me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017</p> <p>GVJ vlereson se AU përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, duke garantuar që NJSBC të funksionojë deri në nivel njesie baze dhe duke përdorur metodologji që kombinon një larmishmeri formash si pyetesore, focus grupe, forma vlerësimi nga drejtuesit dhe vetevlersimin.</p> <p>Për GVJ rezultojnë se AU përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme që konsistojnë në hartimin e raportit nga NJSBC, shqyrtimi në senatin akademik, miratimin e tij dhe lenien e rekomandimeve për të ardhmen. [Evidence 39.a Shkresë fokus grupe.pdf; Evidence 39.b Pergjigje shkresës së shkresës (2).pdf; Evidence 40.a Shkresë RV.pdf; Evidence 40.b Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017.pdf; Evidence 40.c Rekomandimet RV.pdf]</p> <p>GVJ konstaton se AU ka hartuar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. Sic u verifikua nga GVJ gjatë vizitës në institucionin e sigurimit të cilësisë është ndër prioritetet e Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2017-2022 pika 7</p>
---	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**


- Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë në AU është ngritur Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë në përputhje me LAL si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë
- GVJ vlerëson praktiken e ndjekur nga AU që për ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë edhe në nivel njesie baze që prej vitit 2016
- AU përdor një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.
- AU garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, **konkludon se standardet e kësaj fushe permbushen**

**POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

**7. Programi i studimit, organizimi i tij**

**Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj*

Programi i studimit Bsc ne Menaxhim Biznesi, eshte licensuar me VKM nr. 408, datë 26.05.2010, është akredituar për herë të parë me kusht me VKA nr.152, datë 31.03.2016, akredituar me kusht me Urdhër të Ministrisë nr. 240, datë 09.05.2016, Pas plotësimit të kushteve mori akreditimin e parë nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 33, datë 19.05.2017 dhe këtë vit i nënshtrohet akreditimit periodik. Pasi i konsultua me Rregulloren e Programit dhe takimet me stafin, dhe drejtuesit e institucionit, GVJ konstaton se PS ne Bsc. ne Menaxhim Biznesi, ka objektiva si me poshte:

- Të prezantojë studentët me studime të fushës së menaxhimit dhe biznesit në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të ndihmojë studentët të zhvillojnë njohuri dhe shprehje në fushën e menaxhimit;
- Të aftësojë studentët në procesin e vendimmarrjes efektive, nëpërmjet ofrimit të njohurive dhe shprehive përkatëse;
- Të udhëheqë studentët drejt përfitimit të shprehive të të mësuarit që do t'i ndihmojnë ata të jenë të suksesshëm në një ambient biznesi gjithnjë në ndryshim;
- Të zhvillojnë aftësi menaxheriale nëpërmjet përbaljes me situata të ndryshme ku kërkohet zgjidhja e problemeve, dhe të mësuarit nëpërmjet praktikës;
- Të udhëheqë studentët drejt punës kërkimore si pjesë e programit mësimor të lëndëve pjesë përbërëse e programit të studimit, por edhe gjatë përgatitjes së temës së diplomës.
- Të rrisë mobilitetin e studentëve, siç edhe kërkohet nga koncepti i Kartës së Bolonjës.

Programi i studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi, zhvillohet në tre vite akademike dhe permban 180 kredite [Tabela 10 në Aneksë], në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Programi i studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi permban 28 lende si dhe tezen e diplomës.

Lëndët e programit të studimit, Bsc. në Menaxhim Biznesi organizohen në 6 kategori disiplinash:

- |   |         |
|---|---------|
| • Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë       | 30 ECTS |
| • Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit | 93 ECTS |
| • Kategoria C: Disiplina te ngjashme                            | 18 ECTS |
| • Kategoria D: Disiplina me zgjedhje                            | 12 ECTS |
| • Kategoria E: Veprimtari formuese                              | 21 ECTS |
| • Kategoria F: Punimi i Diplomës                                | 6 ECTS  |

Në Tabelën 11 në anekse, jepen edhe të gjithë modulet përkatëse, për secilën kategori të përshkruar me sipër.

Plani mësimor i programit bën një ndarje të lëndëve të detyrueshme, 5 për çdo semestër të vitit te pare dhe te dyte, semestri pare i vitit te trete permban 4 lende dhe semestri i fundit permban 3 lende, praktiken dhe tezen e diplomës.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi i studimit Bsc ne Menaxhim Biznesi, eshte licensuar me VKM nr. 408, datë 26.05.2010, është akredituar për herë të parë me kusht me VKA nr.152, datë 31.03.2016, akredituar me kusht me Urdhër të Ministrit nr. 240, datë 09.05.2016, Pas plotësimit të kushteve mori akreditimin e parë nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 33, datë 19.05.2017 dhe këtë vit i nënshtrohet akreditimit periodik.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Cdo vit ka 2 semestra
- Ora e mesimit eshte 50 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor për pogramin e studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi, jepet ne Anekse, Tabela 10 dhe Tabela 11. Plani mesimor i Programit te studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi permban 28 lende si dhe tezen e diplomës.

Konstatohet se ne ndarjet sipas kategorive, ne Planin mësimor, modulet e kategorisë A (30 ECTS) përbëjnë 17% të totalit të përgjithshëm të krediteve të programit, ndërkohë që modulet e kategorisë B përbëjnë 52% të krediteve të përgjithshme, kategoria C përbën 10%, kategoria D 6%, kategoria E 12% dhe kategoria F 3%. Pesha që zë secila kategori është në përputhje me udhëzimet e Ministrisë per hartimin e planit mesimor

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10-12 orë në auditor 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminarat 6-8 orë në auditor 17-19 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi /Diploma 3 orë në auditor 22 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 20 orë në auditor 5 orë punë e pavarur e studentit

GVJ konstaton se në përcaktimin e numrit të krediteve, njësia bazë dhe ajo kryesore kanë respektuar Udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008, "Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", sipas të cilit një kredit për leksionet vlerësohet me 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë punë e pavarur; për seminarat 6-8 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur, provimi përfundimtar 3 orë në auditor dhe 22 orë punë e pavarur

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 12 ne Aneks)

Nga informacioni i siguruar gjate vizites ne institucion GVJ, konstaton se ne kurrikulen qe do te implementohet gjate vitit akademik 2018-2019, janë bere ndryshime. [Evidence 3. Kurrikulat e propozuara 2018-2019.pdf] .

Keto ndryshime konsistojne ne ndryshimin e numrit te grupit te disiplinave mësimore, nga gjashtë në pesë dhe aplikimi i një modeli të ri syllabusi, sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018.

GVJ vlerëson se këto ndryshime janë ndërmarrë në zbatim të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, duke sjellë perputhshmëri mes menyrës së hartimit të planit mësimor me kërkesat e drivuara nga ndryshimet e kornizes ligjore.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 13 në Aneks)

Plani mësimor i lidhur me stafin akademik qe mbulon cdo lende per vitin 2017-2018, jepet ne tabelën 13 ne shtojcën bashkëlidhur



Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në PS Bsc. në “Menaxhim Biznesi”, përbën 58 % të personelit akademik të angazhuar, për realizimin e programit të studimit. Nga analiza e shpërndarjes së ngarkesës sipas planit mesimor, mes stafit akademik efektiv dhe joefektiv, rezulton se stafi akademik efektiv mbulon 76% të ngarkesës mesimore në këtë program studimi. [Tabela 10, Tabela 13, shtojca bashkelidhur]

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe intervistat e kryera me stafin akademik, u vlerësua roli që kishte udheqesi i çdo lënde në ndërtimin e syllabusit dhe mënyra e ndryshimit të tyre. U konstatua se syllabuset ishin të pandryshura për sa kohë përgjegjesi i lëndës kishte ndërmarre ndryshime të syllabusit në vitin e parë të mësimdhënies. Këto ndryshime bëheshin në Departament përpra fillimit të vitit akademik. Forma e syllabuseve ishte standarte për të gjitha lëndet

Syllabusi përmban këto elementë kryesorë,

- Emertimin e lëndës
- Numri i krediteve
- Emri i udheheqësit të lëndës
- Përshkrimi i lëndës
- Objektivat e lëndës
- Temat që përmban lënda
- Teksi kryesor dhe literatura mbështetëse
- Referenca të tjera literature
- Metodatat e vlerësimit dhe pesha e tyre

Analizë e cilësisë së syllabuseve

GVJ nga informacioni i marrë nga vizita në institucion, konstaton se nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Departamenti në bashkëpunim me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti, angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve në përputhje me të rejtat më të fundit në lëndën përkatëse dhe azhurnimet e literaturës aty ku është e nevojshme. Pavarësisht kësaj procedure, GVJ konstaton se në disa lëndë të këtij programi, literatura ka nevojë për azhurnim me botime më të reja. Literatura e detyruar është në gjuhën shqipe.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Bsc në Menaxhim Biznesi, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike është i akredituar. Gjatë vizitës në institucion GVJ u konsultua me një tabelë përmbledhëse e programeve dhe akreditimeve.</p> <p>Programi i studimit Bsc në Menaxhim Biznesi, është licensuar me VKM nr. 408, datë 26.05.2010, është akredituar për herë të parë me kusht me VKA nr.152, datë 31.03.2016, akredituar me kusht me Urdhër të Ministrit nr. 240, datë 09.05.2016, Pas plotësimit të kushteve mori akreditimin e parë nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 33, datë 19.05.2017. Programi dhe syllabuset janë ndërtuar</p>

	sipas sistemit ECTS, programi zhvillohet ne tre vite akademike dhe cdo vit ka 60 kredite
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njesitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njesitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndet me zgjedhje apo të detyruara për semester;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njesitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njesitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjate vizites ne AU, konstatojme se njesia kryesore dhe përgjegjese per kete program studimi, japin informacionet e nevojshme per permbajtjen e programit te studimit, per lendet dhe modulet, kreditet, format e mesimdhënies, leksione, seminare , laaboratore. Keto informacione publikohen ne faqen zyrtare te internetit [<i>Evidence 4. Kurrikulat ekzistuese 2017 - 2018.pdf</i>] [<a href="http://Albanian_university.edu.al/sq/departamenti-ishkencave-ekonomike/">http://Albanian_university.edu.al/sq/departamenti-ishkencave-ekonomike/</a>]. Nga takimi me studentet e programit, ata demonstrojne se jane te informuar ne lidhje me lendet qe kane cdo semester, informim ky qe realizohet ne javen e pare te cdo semstri nga pedagoget e lendeve si dhe nga Zyra per mbeshtetjen e studenteve. Ky informim fokusohet ne ngarkesen qe ka cdo lende, temat qe do te zhvillohen, literature, format e vleresimit, detyrimet e cdo lende, frekuentimin e saj etj.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- AU ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</li> <li>- Programi i studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi eshte i detajuar dhe informues, ne lidhje me lendet qe permban, kreditet e tyre, semstrin kur zhvillohet, ngarkesen leksione/seminare/ore laboratorike, si dhe syllabuset e tyre.</li> </ul>	
<b>Per sa me siper GVJ konkludon se standardet e kesaj fushe permbushen</b>	
<u>Rekomandime</u>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstaton se ne syllabuset e disa lëndëve te këtij programi, literatura ka nevojë për azhornim me botime me te reja.</li> </ul>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.*

GVJ gjate vizites ne institucion dhe takimeve qe u zhvilluan me stafin e programit, me studentet qe ndjekin kete program studimi por edhe me drejtues te njesise baze, konstatoi se, metodat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programin e studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi, janë të shumëllojshme. Krahas formave të mësimdhënies një drejtimore (nga pedagogu tek studentët), këto metoda tentojnë drejt formave të mësimimit me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student.

Në programin e studimit, Bsc. në Menaxhim Biznesi procesi i mësimdhënies zbatohet sipas syllabusit të çdo lënde dhe në liri të plotë të personelit akademik. Ngarkesa mësimore në leksione e seminare për studentët realizohet konform udhëzimeve të nxjerra nga MASR në zbatim të legjislacionit.

Personeli akademik organizon procesin mësimor sipas komponentëve të shprehur në syllabus. Personeli akademik përdor mjetet didaktike si raste studimore, slide, tekste shtesë, si dhe teknologjinë e vendosur në auditorë – PC dhe Video –projektorë.

Kontrolli i njohurive realizohet sipas metodologjisë së përshkruar në syllabusin e lëndës ku personeli akademik plotëson të gjitha komponentët me pikët përkatëse, nga ku provimi final ka 60% të vleresimit total të studentit. GVJ vlerëson faktin, që provimet zhvillohen të sekretuara.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet: [Tabela 14, Aneks]

• Leksione	990 orë
• Seminare	720 orë
• Laboratore	N/A
• Praktikë lëndore	N/A ore
• Praktikë profesionale	45 orë
• Diploma	75 orë

Ndërkohë ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies Leksione, Seminare, dhe punim diplome, është 1830 ore. [Tabela 14, Aneks]

Ndarja e mesiperme në forma të ndryshme mesimdhënies si dhe orët e dedikuara në planin mesimor, për secilin nga këto forma, është në përputhje me kërkesat ligjore për këtë nivel studimesh.

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të dijeve të studentit realizohen me anë të disa elementëve; ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10%, plotësimi i detyrimeve 10%, testimet gjatë vitit 20% dhe testi përfundimtar 60%. Në detaje këta elementë dhe peshat që ata zënë ndaj totalit të vlerësimit të përgjithshëm jepen në Tabelën 15, në Aneks dhe nga syllabuset e lendeve, vihet re se është standarde për të gjitha lëndet.

GVJ është e mendimit se ndarja e mesiperme siguron vlerësimin gjithsemestral të studenteve, duke rritur aktivizimin e tyre gjatë semestrit, dhe duke i shërbyer me mirë formimit të tyre profesional, por edhe vlerësimit me objektiv

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 16 në Aneks)

Gjate vizitës në institucion dhe informacionit të siguruar se pari nga studentet e këtij programi studimi, por edhe nga stafi akademik i programit, konstatohet pjesëmarrja e studenteve në aktivitete të tilla si konferenca studentore [Evidence 32. Konferenca e AMF.pdf] Nga pjesëmarrja në këto konference disa prej studenteve të këtij programi studimi, kanë qenë fitues të çmimeve të dhëna. Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, u konstatuan pjesëmarrje e studenteve në organizime të aktiviteteve të ndryshme, si leksione të hapura, tryeza të rrumbullakta, seminare informuese etj. [Evidence, 35.1 Kalendari i Aktiviteteve Zyra e Karrieres (1).PDF, Vizita në institucion]

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

*Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.*

GVJ nga takimet me studentët, stafin akademik, stafin mbështetës dhe drejtues, konstatoi se, institucioni ne procedurat e pranimit ne Programin e Studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi, respekton kërkesat qe burojnë nga aktet ligjore dhe nenligjore, dhe se AU nuk vendos kritere te tjera shtese per pranimin e studenteve ne kete PS.

Referuar informacionit te RVB dhe te siguruar nga vizita ne institucion, rezultoi se në vitin akademik 2017 – 2018, u regjistruan 37 studentë për herë të parë në vitin e parë me mesatare hyrëse 7.05, dhe 20 studentë të transferuar në vitet e ndërmjetme; u diplomuan 68 studentë. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe frekuentimi i aktiviteteve formuese në auditor është i detyrueshëm në masën 75%

Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban të dhëna për punësimin e studentëve dhe ruan marrëdhëniet me ta edhe pas mbarimit të programit të studimit, ku qëllimi i saj është jo vetëm ndarja e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.

### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

Procedurat e pranimit të studentëve

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare mbi 6 dhe kanë përfutur njëri nga diplomat e mëposhtme:

- Maturën shtetërore;
- Diplomën e shkollës së mesme (të përgjithshme ose të profilizuar, sistemi i vjetër);
- Diplomë e shkollës së mesme profesionale 5 vjeçare;
- Dëftesa e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të në Shqipëri.

Referuar RVB por edhe informacionit te deklaruar ne faqen zyrtare te universitetit, kriteret specifike, për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi janë:

- Mesatarja e Përgjithshme e Maturës 70%
- Mesatarja e gruplëndëve të mëposhtme 30%, ku secila lëndë ka peshën:
  - Ekonomi 15%
  - Matematikë 10%
  - Anglisht 5%

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Referuar tabelës 17 ne shtojcën bashkëlidhur dhe te verifikuar gjate vizitës ne institucion, konstatohet se ne vitin akademik 2017-2018, janë te rregjistruar 37 studente. Nota mesatare e te rregjistruarve gjate 2017-2018 ishte 7.05

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

AU ka një procedurë të qartë të transferimit të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend. Procedura e transferimit bazohet në Udhezimet që nxjerr MASR në vitin akademik përkatës, dhe në Statutin dhe rregulloren e AU

Të dhëna për punësimin e studentëve

GVJ konstaton nga informacioni i siguruar nga Zyra e Karrieres dhe statistikat qe ata mbajne, rezulton se 35% e te diplomuarve jane te punesuar ne perputhje me diplomën, ndersa 25% jane te punesuar jo ne perputhje me diplomën. Vihet re se numri i të punesuarve në përputhje me diplomën është më i lartë, se ai jo në përputhje me diplomën.



Numri total të diplomuarve

Referuar tabelës 17, ne shtojcën bashkëlidhur, ne vitin akademik 2017-2018, konstatohet se numri total i te diplomuarve eshte 68 studente

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi I dosjeve te studenteve te rregjistruar konstaton se pranimi tyre eshte kryer sipas udhëzimeve të MAS, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe eshte respektuar kufiri minimal i mesatares 6 [Evidence, 9.1.Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve.pdf, Evidence 9.3.Manuali i Studentit.pdf]</p> <p>GVJ konstatoi vendosjen e kriterëve specifike per pranimin e studenteve si me poshtë: [Evidence 9.2.Percaktimi i Kriterëve per Pranimin ne Program.pdf]</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mesatarja e Përgjithshme 70%</li> <li>• Mesatarja e gruplëndëve 30%: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ekonomi 15%</li> <li>○ Matematikë 10%</li> <li>○ Anglisht 5%</li> </ul> </li> </ul>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka menyra alternative per informimin e studenteve per programin e studimeve. Studentet e Bsc. ne Menaxhim Biznesi, rezultoi se informohen ne menyre te detajuar, perpara se ata te rregjistrohen ne kete program studimi nga Zyra per Mbeshtetjen e studenteve, nga pedagoget e lendes, ne javen e pare te semestrit, nga faqja zyrtare e institucionit</p> <p>Referuar informacionit te siguruar nga NJSBC dhe te konfirmuar nga studentet e programit, rezulton se studentet marrin pjese ne pyetesoret per vleresimin e pedagoqeve 2 here ne vit (cdo semester), si dhe percjellin idete e tyre edhe nepermjet pjesemarrjes ne fokus grupe.[Evidence, 3.3.b.Model Pyetesori Studenti.pdf, Evidence 3.3.c.Fokus grupet e NJSBC.pdf]</p> <p>Zyra e Karrieres në përfundim të vitit të tretë akademik, u jep studentëve informacion për mundësitë për punësim pas</p>

	diplomimit, si dhe ju vihet në dispozicion “Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës”
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>GVJ konstaton se AU disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në kete program e studimi. Këto të dhëna raportohen çdo vit pranë Drejtorisë së statistikave në MAS. Ndërkohë të dhënat e të diplomuarve mbahen në regjistrin përkatës dhe që u kontrolluan gjate vizitës ne institucion</p> <p>AU mban statistika vjetore të rregullta për numrin e të regjistruarve në programin e studimit Bsc. ne Menaxhim Biznesi. GVJ ju vendosen ne dispozicion statistika rreth studenteve te regjistruar në vite dhe ecurisë së tyre. <i>[Tabela 17 në Aneksë].</i></p> <p>Gjate vizitës ne sekretarinë e AU dhe nga vëzhgimi i regjistrave u identifikuan disa raste te studenteve pa numër matrikullimi. Vonesa e pajisjes me numër matrikullimi ka ardhur per shkak te procedurave verifikuese, dhe per kete institucioni vendosi ne dispozicion te GVJ korrespondencen me MASR, qe argumenton kete vonese <i>[Evidence 27.2 Shkrese nga QSHA per matrikullimin e studentetve.pdf, Vizita ne institucion]</i></p> <p>GVJ konstatoi se AU disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit studimor që nga pranimi deri në prag të diplomimit, dokumentacion ky që u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion. Keto të dhëna u siguruan ne dokumenta te tille si regjistri i themeltar, regjistri i notave, regjistri i diplomave si dhe regjistri i cdo lende.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tille.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar ne institucion, nga drejtues te njesise baze si dhe stafi dhe studentet, rezulton se departamenti ofron udhëheqje dhe kujdestari për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p>Referuar dokumentacionit ne sistemin AMs, rezultojne 22 organizata biznesi dhe institucione me te cilat, AU ka marreveshje per zhvillimin e praktikave te studenteve Departamenti me mbështetjen e ZKMS orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilën do të zhvillojnë praktikën mësimore. <i>[Evidence 11.2.Marreveshje bashkepunimi me organizata dhe biznese.pdf]</i></p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Au ndjek një politikë të orientuar drejt respektimit te bazes ligjore per rregjistrimin e studentëve të rinj</li> </ul>	

- AU informon studentët në lidhje me politikat e punësimit, nepermjet Zyres se Keshillimit te Karrieres
- Personeli I AU eshte i angazhuar ne perkujdesjen ndaj studentëve te programit, per tju siguruar atyre informacion dhe mbeshtetje gjate viteve te studimit si dhe orientim dhe keshillim karriere

**Per sa me sipër GVJ konstaton se standardet e kesaj fushe permbushen**

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.*

Kërkimi shkencor, është eshte nder prioritetet kryesore te strategjisë zhvillimit AU, e rregulloreve dhe strukturave përkatëse për organizim dhe ndjekje. Politika e Departamentit të Shkencave Ekonomike në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor është një politike ne funksion të implementimit te strategjise se AU per kerkimin shkencor.

Puna shkencore e stafit akademik te programit PS, Bsc. ne Menaxhim Biznesi, konsiston në drejtime kryesore si: kërkim bazë ose të aplikuar; studime dhe projekte për zhvillim; veprimtari të tjera krijuese me objektiva specifike të institucionit si në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij; në procesin akademik me programe, teori dhe praktika sipas Kartës së Bolonjës.

Nga struktura e AU, konstatohet se për kërkimin shkencor ne nivele drejtuese te institucionit, eshte Zv/Rektorin për Kërkimin Shkencor, i cili synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor. Strategjia per kerkimin shkencor eshte miratuar nga senati akdemik

AU synon te garantoje nje përmirësim te raportit punë mësimore dhe shkencore dhe nje përfshirje dhe angazhim edhe te studentëve në veprimtarite kerkimore-shkencore te institucionit por edhe jashtë tij. Referuar RVB, por edhe nga informacioni i marre gjate vizitave ne AU, përfshirja e pedagogëve në projekte të kërkimit shkencor, por edhe ne botime ne revista akademike, ka qenë kryesisht mbi bazen e prioriteteve individuale, në kuadër të projekteve të tyre të doktoraturës ose per marrjen e titujve akademike

Përveç pririteteve individuale qe stafi akademik ka, AU në mbeshtetje te rritjes se produktit te kerkimit shkencor te institucionit, ka pjese integrale te strukturave te saj edhe Zyren e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike si dhe Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet. GVJ nga vizita ne institucion konstaton se AU boton nje periodik qe është revista "OPTIME", me ISBN dhe me bord editorial, qe ka botime ne disa fusha ku jane te perqendruara programet e studimit te AU, mes tyre dhe botime ne fushen e ekonomise. Kjo reviste konstatohet nga takimet me drejtues dhe me stafin akademik te programit, se ka mbeshtetur iniciativat per botime te stafit akademik, botime të cilat kanë plotësuar kriteret qe revista ka. GVJ nuk konstatoi nje norme mesatare te pranimit/refuzimit te artikujve ne kete reviste.

GVJ vlereson iniciativen e pervitshme te Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike, per organizimin e Konferencës [Evidence, 10.2.Thirrja e Konferences Nderkombetare.pdf; Dosja e vetevleresimit] në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universitetin La Sapienza, Romë si dhe dhe Konferencën Studentore ne bashkepunim me AMF, me temë "Zhvillimi i qëndrueshëm" [Evidencë 10.3.Thirrja e Konferences Studentore.pdf, Dosja e vetevleresimit, Evidence 36.

*Botim Konferenca Studentore.pdf*. Nga takimi me studentet e ketij programi, pavaresisht se ishin studente qe kryesisht kishin mbaruar vitin e pare te studimeve ne kete program, pjesemarrja e tyre ne kete konference kishte qene motivuese dhe ata ishin vleresuar me cmime simbolike nga organizatoret e konferences

Persa i perket projekteve sugjerohet nje perfshirje me e madhe e stafit te njesise baze ne projekte kombetare apo nderkombetare. Deri tani sic raportohet nga RVB si dhe nga takimet me drejtues te njesise kryesore dhe baze, njesia baze ka aplikuar ne 4 projekte, dhe eshte fituese e nje Erasmus+ me Kolegjin Powislanski ne Poloni, nga e cila ka perfituar mobilitet 1 student nga AU dhe 4 pedagogë.

Nga informacioni i siguruar nga dosja e vetevleresimit por edhe nga takimet me drejtues dhe stafin akademik te programit, GVJ konstaton se AU i krijon stafit akademik, mundësinë e pjesemarrjes ne konference nderkombetare, duke ju akorduar lejen e paguar ne te tilla raste si dhe pjesemarrjen me tarife te reduktuar ne aktivitetet shkencore qe zhvillon AU

GVJ konstaton nga informacioni i vendosur ne dispozicion nga institucioni, se mbështetja financiare nga institucioni ka ekzistuar, por GVJ e konsideron nivele relativisht te ulta. [*Evidence, 10.8.Financimet e Universitetit per Pedagoget.pdf, Dosja e vetevleresimit*]

Per sa me sipër GVJ sugjeron intensifikimin e mbështetjes financiare ndaj stafit akademik per pjesemarrjen e tyre ne aktivitete shkencore dhe trajnime si dhe vendosjen e nje sistemi te matjes dhe te vleresimit te kontributin te tyre shkencor si dhe te motivimit te tyre.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 19 dhe 20 ne aneks)

GVJ konstaton se puna shkencore në AU ka shënuar rezultate dhe përmirësime, në aspektin institucional, mbështetjes dhe ndjekjes me struktura administrative dhe shkencore, në planifikimin dhe koordinimin e saj, problematikën e trajtuar, larminë e punës shkencore, etj. Eshte rritur prezenca individuale dhe institucionale e AU dhe stafit të tij në publikime, konerenga, pjesemarrje në projekte, angazhime të studentëve,etj. Referuar Tabeles 16, ne shtojcën bashkëlidhur, identifikohen 20 punime shkencore individuale ne kadrin e artikujve dhe konferencave. Referuar tabelës 16, ne rang departamenti janë 11 dhe projete shkencore, ndërsa ne bashkëpunim me institucione te tjera janë 13 projekte.

AU publikon revistën periodike "Optime" dy herë në vit e cila përmban artikuj shkencorë të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU.

Referuar RVB si dhe dokumentacionit te siguruar ne institucion, konstatohet se njësia baze ka fituar një Erasmus+ me Kolegjin Powislanski në Poloni, nga e cila ka përfituar mobilitet 1 student nga AU dhe 4 pedagogë

Ne kuadër te projekteve konstatohet se departamenti gjatë vitit akademik 2017-2018 ka realizuar aplikime në 4 projekte

1. 1.Spreading Excellence and Widening Participation – part of H2020;
2. H2020-MSCA-NIGHT-2018;
3. International open innovation center applying Triple Helix Model: Academia, Government, and Industry;
4. 4.EACEA Programme "Europe for Citizens": Democratic engagement and civic participation.

Institucioni është pjesë e projektit "GRADUA" ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë te perfshire edhe ne programin e studimit Bsc.

Vleresohet pjesemarrja e AU ne projektin "GRADUA", ku nga departamenti i Shkencave Ekonomike janë të përfshirë dy pedagogë.



- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjate vizitës në institucion në lidhje me kërkimin shkencor, me kerkese të GVJ u siguruan informacione mbështetëse rreth statistikave që institucioni raporton në RVB, të cilat u konsultuan nëpërmjet sistemit AMS, si Evidenca 36. Botim Konferenca Studentore.pdf, Evidenca 34.1 Visit Schedule\_Powislański College in Kwidzyn.pdf, Evidenca 34.2 Visit\_Agenda.pdf, 33.2 E\_mail për bashkëpunimin e konferencës.pdf, Evidenca 33.1 Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare - konference - AU.pdf, Evidence 30.1 Formulari i kerkimit shkencor PAE Bachelor.pdf

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

*Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.*

GVJ duke iu referuar informacionit në sistemin AMS të siguar nga dosja e vetëvlerësimit në mënyrë të përmbledhur, por edhe nga vizita në institucion me raste me specifike, konstatohet se Fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi me 22 institucione dhe biznese të ndryshme me të cilët ruan edhe kontakte të vlefshme në kuadër të studimit të tregut të punës si dhe të organizimit të praktikave të studenteve. Në këtë kuadër GVJ vlerëson marrëveshjet që ka AU me institucione të tjera brenda vendit, me fokus zhvillimin e praktikave profesionale të studenteve të programit të studimit Bsc. Në Menaxhim Biznesi. [Evidence, 11.2. Marrëveshje bashkëpunimi me organizata dhe biznese.pdf, Dosja e vetëvlerësimit, Evidence 28.2 Marrëveshje bashkëpunimi me Univ. Tiranës.pdf, Vizita në institucion].

Gjatë vizitës në institucion, si dhe nga shqyrtimi i informacionit të depozituar në sistemin AMS, konstaton se AU dhe FSHAE ka 7 marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja dhe shqiptare, si universiteti i Tiranës, Universiteti i Durrësit "Aleksander Moisiu", Kolegji Powislanski, Poloni, Universiteti "Angel Kanchev" Ruse [Tabela 21]. Keto bashkëpunime janë në fusha të shkëmbimit të stafit akademik për mesimdhënie, kryesisht mes AU dhe universiteteve shqiptare, si dhe bashkëpunime në pjesëmarrje në projekte të përbashkëta dhe në organizimin të ndërsjelle të aktiviteteve shkencore. [Evidence, 11.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete.pdf, Evidence 28.2 Marrëveshje bashkëpunimi me Univ. Tiranës.pdf, Vizita në institucion, Evidence 28.1 Marrëveshje bashkëpunimi me UBT.pdf]

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 21 në aneks)

Në tabelën 21 bashkelidhur këtij raporti gjenden të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, ku konstatohen 22 institucione dhe organizata private me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadër kryesisht të organizimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale që studentet e këtij programi studimi dhe të programeve të tjera që AU ka. Pavarësisht këtyre marrëveshjeve ndërinstitucionale, nga informacioni i siguruar gjatë takimeve me përfaqësues të Zyrës së Karrierës në AU, konstatohet se një pjesë e studenteve i kryejnë praktikën mbi bazën e identifikimit individual të vendit të praktikës, duke qenë se janë në marrëdhënie pune.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	

**Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.**

**Kriteri 1** Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

**Kriteri 2** Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Për mirefunksionimin e programit të studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi, në kuadër të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare, GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në AU strukturat akademike dhe strukturat administrative kanë një bashkëpunim efektiv. Ky bashkëpunim ka në fokus shkëmbimin e informacionit dhe integrimin e shërbimeve cilësore të ofruara ndaj studenteve.

GVJ konstaton se mbështur mbi rregulloret respektive janë janë të përcaktuara qarte detyrat e stafit.

Mbi këto ndarje të detyrave dhe varësisë strukturale që kanë, punonjësit e çdo zyre raportojnë në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e kryer në instancat nga të cilat varet, duke garantuar transparencë dhe bashkëpunim të frytshëm midis strukturave të institucionit.

**Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.**

**Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

**Kriteri 2** Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të metejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Referuar shqyrtimit të informacionit të depozituar në sistemin AMS, GVJ konstaton se AU dhe FSHAE ka 7 marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja dhe shqiptare dhe 22 marrëveshje me institucione dhe organizata biznesi.

Marrëveshjet që AU ka me organizatat publike dhe private, kanë në fokus kryesor, mbështetjen e studenteve për zhvillimin e praktikave profesionale

GVJ nuk konstatoi një raport analitik të AU për përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programit të studimeve, por GVJ nga informacioni i siguruar vlerëson se marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet janë aktive dhe prodhojnë vlerë për institucionin në teresi, dhe për programin e studimit në vecanti, në kuadër të mbështetjes me staf akademik për AU, konferenca të përbashkëta dhe mbi të gjitha për zhvillimin e praktikave profesionale të studenteve etj. *[Dosjet e stafit pranë burimeve njerezore, Vizita në institucion]*

**Konkluzionet e vlerësimit:**

- AU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me universitete dhe institucione të huaja dhe vendase.
- Departamenti ka marrëveshje me 22 organizata publike dhe private në kuadër të praktikave mësimore
- Strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën për një mbarëvajtje sa më të mirë të programit të studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi.

**GVJ konkludon se standartet e kësaj fushe përmbushen**

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

GVJ duke iu referuar konkluzioneve të akreditimit të mëparshëm, nga informacioni i siguruar nga dosja e vetvlerësimit, si dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, konkludon se IAL Albania University, ka ndermarre një teresi masash për plotësimin e tyre në vazhdimësi. Për sa me siper GVJ konkludon:

	<b>Rekomandimet nga akreditimi i parë</b>	<b>Statusi aktual</b>
1	Numri i stafit akademik efektiv me grada e tituj dhe Raporti Personel Akademik Efektiv/ personel Akademik me kontratë është përmirësuar, por ende nuk është në përputhje të plotë me standardet e kërkuara;	Përbushur
2	Stafi akademik efektiv është i përfshirë në më shumë se dy detyra dhe ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv nuk përcaktohet në mënyrë të detajuar;	Kryesisht i Përbushur
3	Nuk ka evidence në dokumentimin e aktiviteteve si leksione të hapura, seminare, workshop, etj.;	Përbushur

### II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

#### a. Pika të forta:

- Njesia bazë ka rritur rekrutimet e stafeve akademike efektive me tituj dhe grada vitet e fundit
- Staf akademik joefektiv me tituj dhe grada shkencore si dhe me eksperience
- Staf administrativ i përkushtuar që ofron zgjidhje për problemet si për personelin akademik dhe për studentët
- Përfshirje e studenteve në konferenca studimore në bashkëpunim me institucione të tjera
- Vendndodhje strategjike e institucionit, që e bën atë lehtësisht të arritshëm për studentet, si dhe afërsia me institucionet e tjera.
- Strukturë organizative efektive
- Funksionimi i NJSBC në nivel njësie baze
- Departamenti në bashkëpunim me NJSBC angazhohet në vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe atij administrativ.
- Përdorimi i mekanizmave të shumfishte për vlerësimin e performancës së stafit akademik

#### b. Pika të dobëta:

- Ambiente të zyrave të pamjaftueshme për stafin akademik
- Numri i laboratorëve dhe kapaciteteve kompjuterike në dispozicion të studentëve
- Mangësi në plotësimin e regjistrave për frekuentimin e studenteve
- Pjesëmarrje dhe aktivizim relativisht i ulët i stafit akademik në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar;
- Burimi kryesor i financimit, me 99.5 % janë tarifët e studimit dhe deri tani institucioni nuk ka siguruar diversifikim të burimeve të financimit nga grantet, projektet, konsulentat apo donacionet.

- Mbështetje financiare e vogël për të nxitur pjesëmarrjen e stafit akademik të programit të studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi

#### c. Mundësitë

- Kërkesë e lartë për ndjekjen e studimeve universitare në vend
- Mundësi mobilitetit të studentëve, e financuar nga BE nëpërmjet projektit Erasmus+.
- Fondi i bibliotekës duhet të pasurohet me botimet e fundit të fushave respektive, që lidhen me PS Bsc. në “Manaxhim Biznesi”, literaturë e cila mund të sigurohet në burime të ndryshme të cilat ekzistojnë.
- Mundësi bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperience me universitete të tjera në vend dhe jashtë tij
- Mundësi angazhimi e pedagogëve joefektiv nga universitete të tjera në vend
- Mundësi për të tërhequr studentë me mesatare të lartë nëpërmjet ofrimit të bursave.

#### d. Pengesat

- Konkurrencë e larte nga universitetet publike dhe private qe ofrojnë programe te përafërta studimi
- Emergjencia për qasje të reja në sistemin arsimor dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionit për arsimin e larte ne Shqiperi
- Maturimi i tregut për profesionet e lidhura me shkencat ekonomike
- Mungesa e nje studimi te mirëfilltë kombëtar për nevojat e tregut të punës për manaxhere biznesi

#### Rekomandime:

- *GVJ sugjeron që në të ardhmen të intensifikohen përfshirja e stafit në trajnime të vazhdueshme dhe që i shërbejnë në mënyre të drejtëpërdrejtë personelit të njësisë bazë, që shkojnë përtej mësimdhënies, si p.sh për metodologjitë e kërkimit shkencor si dhe atyre të shkrimit dhe aplikimit për projekte, etj*
- *GVJ sugjeron që AU të intensifikoje përpjekjet për përditesimin e literaturës dhe shtimin e fondit të bibliotekës, me botimet e fundit të fushave respektive që lidhen me programin e studimit Bsc. në Menaxhim Biznesi*
- *GVJ sugjeron shtim te ambienteve per stafin akademik te departamentit.*
- *GVJ sugjeron shtim të laboratoreve dhe kapaciteteve kompjuterike në godinën kryesore.*
- *GVJ sugjeron diversifikimin e burimeve financiare, jo vetëm nga tarifat e studimit si deri tani dhe që kane ardhur duke u zvogëluar, por edhe nga burime te tjera te tjera si grantet, konsulencat, projektet.*
- *GVJ konstaton se ne syllabuset e disa lëndëve te këtij programi, literatura ka nevojë për azhornim me botime me te reja.*

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. Dr. Halit Xhafa

Prof. As. Dr. Etleva Leska

**ANEKS**

- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat

Tabela 1

IAL	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (Viti akademik 2017 - 2018)						Total
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	
<b>Departamenti i Arkitekturës</b>	21	(1) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. Dr. (7) Dr. (1) Dr.proc. (11) MSc.	19	(4) Prof. Asoc. Dr. (10) Dr. (4) Dr.proc. (1) MSc.	10 <sup>1</sup>	(1) Prof. Asoc. Dr. (5) MSc. (2) MP (1) BSc. (1) M	48 <sup>5</sup>
<b>Departamenti i Inxhinierive</b>	23	(2) Prof. Asoc. Dr. (8) Dr. (2) Dr.proc. (11) MSc.	14	(1) Prof. Dr. (7) Prof. Asoc. Dr. (5) Dr. (1) MSc.	12 <sup>2</sup>	(1) Dr. (6) MSc. (2) MP (2) BSc. (1) M	48 <sup>5</sup>
<b>Departamenti i Shkencave Ekonomike</b>	28	(1) Prof. Dr. (4) Prof. Asoc. (11) Dr. (3) Dr.proc. (9) MSc.	23	(3) Prof. Dr. (9) Prof. Asoc. (5) Dr. (1) Docent (5) MSc.	12 <sup>3</sup>	(1) Prof. Asoc. (7) MSc. (2) MP (1) BSc. (1) Arsim i Mesëm	56 <sup>5</sup>
<b>Në total</b>	<b>72</b>		<b>56</b>		<b>22<sup>4</sup></b>		<b>140<sup>4, 5</sup></b>

<sup>1</sup> përgjegjës departamenti, përgjegjës programi i studimit Dizajn, 1 asistente departamenti, kryesekretare FSHAE, 1 sekretare mësimore, administratore FSHAE, punonjëse biblioteke FSHAE, 1 përgjegjës IT, 2 specialistë IT;

<sup>2</sup> përgjegjës departamenti, 2 asistente departamenti, kryesekretare FSHAE, 2 sekretare mësimore për programet e studimit Bachelor në Inxhinieri, 1 sekretare mësimore për programet e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri, administratore FSHAE, punonjëse biblioteke FSHAE, 1 përgjegjës IT, 2 specialistë IT;

<sup>3</sup> përgjegjës departamenti, 1 asistente departamenti, 1 kryesekretare FSHAE, 2 sekretare mësimore për programet e studimit Bachelor, 1 sekretare mësimore për programet e studimit Master, 1 administratore FSHAE, punonjëse biblioteke FSHAE, punonjëse fotokopje, 1 përgjegjës IT, 2 specialistë IT;

<sup>4</sup> kryesekretare FSHAE, administratore FSHAE, punonjëse biblioteke FSHAE, 1 përgjegjës IT, 2 specialistë IT janë numëruar 1 herë;

<sup>5</sup> përgjegjësit e departamentit dhe përgjegjësi i programit të studimit Dizajn janë edhe personel akademik efektiv dhe janë numëruar 1 herë.

Tabela 1

Departamenti i Shkencave Ekonomike përgjegjës për programin Bachelor në Menaxhim Biznesi (Viti akademik 2017 - 2018)							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli / Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli / Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Agron Tato	Pedagog	Prof.Dr.	1	Adriatik Kotorri	Prof.Asoc.	FEUT
2	Aida Veliaj	Pedagog	MSc.	2	Agron Kodra	Docent	Pension
3	Almarin Frakulli	Pedagog	Dr.proc.	3	Albana Jupe	Prof.Asoc.	UBT
4	Amanda Vrioni	Pedagog	Dr.proc.	4	Amalia Tola	Dr.	UBT
5	Armalda Reçi	Pedagog	MSc.	5	Dafina Cenaj	Dr.	MASR
6	Artur Ribaj	Pedagog	Prof.Asoc.	6	Eda Bezhani	Prof.Asoc.	UAMD
7	Avis Andoni	Pedagog	Dr.	7	Elida Liko	Prof. Asoc.	FEUT
8	Besjana Tosuni	Pedagog	Dr.	8	Ermira Shtino	Ma.	APIDSSH
9	Besmir Kanushi	Pedagog	MSc.	9	Etleva Bajrami	Prof.Asoc.	FEUT
10	Dorina Guraj	Pedagog	Dr.	10	Etleva Dashi	Prof.Asoc.	UBT
11	Eriona Xhaferaj	Pedagog	MSc.	11	Fiqiri Baholli	Dr.	UBT
12	Ervis Bejko	Pedagog	Dr.	12	Galantina Canco	Prof.Dr.	UBT
13	Evis Sila	Pedagog	MSc.	13	Gentjana Sharku	Prof.Asoc.	FEUT
14	Fatmira Kola	Pedagog	Dr.proc.	14	Klodiana Gorica	Prof. Dr.	FEUT
15	Genti Çela	Pedagog	Dr.	15	Ledia Kazazi	Dr.	U ELBASANIT
16	Ilda Kadrimi	Pedagog	MSc.	16	Marsida Omari	MSc.	Kryeministri
17	Ingrid Konomi	Pedagog	Dr.	17	Nevila Baci	Prof.Asoc.	FEUT
18	Klodia Kola	Pedagog	MSc.	18	Ornela Kullolli	MSc.	AMF
19	Lek Pepkolaj	Pedagog	Dr.	19	Pandi Madhi	MSc.	TBU

20	Manjola Kapedani	Pedagog	Dr.	20	Perseta Grabova	Dr.	FEUT
21	Manuela Meçe	Përgjegjës	Prof.Asoc.	21	Stavri Sinjari	Prof.Asoc.	AS
22	Marsela Tafa	Pedagog	MSc.	22	Vasilika Kume	Prof.Dr.	FEUT
23	Miranda Harizaj	Pedagog	Dr.	23	Zamir Kurushi	MSc.	AAPA
24	Remzi Sulo	Pedagog	Prof.Asoc.				
25	Rezana Balla	Pedagog	Dr.				
26	Setki Mulla	Pedagog	Prof.Asoc.				
27	Sonila Daiu	Pedagog	Dr.				
28	Sonila Shamku	Pedagog	Ma.				

Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (plotëso Tabelën 3)

Tabela 3

Stafi akademik për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi (Viti akademik 2017 - 2018)							
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Agron Tato	Pedagog	Prof.Dr.	1	Agron Kodra	Docent	Pension
2	Aida Veliaj	Pedagog	MSc.	2	Albana Jupe	Prof.Asoc.	UBT
3	Almarin Frakulli	Pedagog	Dr. proc.	3	Dafina Cenaj	Dr.	MASR
4	Amanda Vrioni	Pedagog	MSc.	4	Eda Bezhani	Prof.Asoc.	UAMD
5	Armalda Reçi	Pedagog	Dr.proc.	5	Elida Liko	Prof.Asoc.	FEUT
6	Avis Andoni	Pedagog	Dr.	6	Ermira Shtino	Ma.	APIDSSH
7	Besmir Kanushi	Pedagog	MSc.	7	Galantina Canco	Prof.Dr.	UBT
8	Genti Çela	Pedagog	Dr.	8	Klodiana Gorica	Prof.Dr.	FEUT
9	Ilda Kadrimi	Pedagog	MSc.	9	Ledia Kazazi	Dr.	UAXHE
10	Ingrid Konomi	Pedagog	Dr.	10	Marsida Omari	MSc.	Kryeministri
11	Klodia Kola	Pedagog	MSc.	11	Ornela Kullolli	Ma.	AMF
12	Manjola Kapedani	Pedagog	Dr.	12	Pandi Madhi	MSc.	TBU
13	Manuela Meçe	Përgjegjës dep.	Prof.Asoc.	13	Perseta Grabova	Dr.	FEUT
14	Marsela Tafa	Pedagog	MSc.	14	Stavri Sinjari	Prof.Asoc.	AS
15	Remzi Sulo	Dekan i FSHAE	Prof.Asoc.				
16	Rezana Balla	Pedagog	Dr.				
17	Setki Mulla	Pedagog	Prof.Asoc.				
18	Sonila Daiu	Pedagog	Dr.				
19	Sonila Shamku	Pedagog	Ma.				

Të dhënat e stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 4)

Tabela 4

Titulli	Stafi akademik për programin e studimit (Viti akademik 2017-2018)		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	2	1/2
Profesorë të As.	3	4	3/4
Dr/Phd	6	4	3/2
Pedagogë ne proces Dr	2	0	-
Asistentë me Msc	7	4	7/4
Personeli Administrativ	9		

Të dhëna sipas moshës (Tabela 5 dhe 6)

Tabela 5

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					1
Profesorë të As.			1	2	
Dr/Phd	2	4			
Pedagogë ne proces Dr	2				

Asistentë me Msc	7			
Personeli Administrativ	8	1		

Tabela 6

Personeli sipas titujve / gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë				1	1
Profesorë të As.		3		1	
Dr/Phd	2	1			1
Asistentë me Msc		3		1	

Mjediset e fakultetit (Tabela 7)

Tabela 7

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	10	1,120.2
Klasa për seminare	20	1,005
Salla për aktivitete promovuese	1	245
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	0	0
Laboratorë për lëndët	1	50
Laboratorë informatike	1	35
Salla interneti	0	0
Salla për bibliotekë	1	248.6
Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1	7
Zyrë informacioni për studentët	1	6
Korridore/holle	11+	645
Mjedise sportive	0	0
Mjedise shërbimi për të tretë	2	567
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	16
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj.	2	567
Nyje hidrosanitare për studentët	6	106.4
<b>Norma m<sup>2</sup>/për student</b>	<b>4618.2 m<sup>2</sup>/652 studentë = 7.08 m<sup>2</sup>/student</b>	

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zyrë mbledhjesh	1	21.3
Zyra për sekretarinë mësimore	2	56.17
Zyra për departamentin	1	21.3
Zyra për personelin akademik të departamentit	1	21.3
Zyrë për financën	2	47
Zyrë për Njësinë e SBC	1	23.2
Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve <sup>4</sup>	1	14.8
Zyrë për IT <sup>4</sup>	1	20
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2	6.40
<b>Norma m<sup>2</sup>/për person</b>	<b>231.47m<sup>2</sup>/69 persona = 3.4 m<sup>2</sup>/person</b>	

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit (Tabela 8)

Tabela 8

Të ardhurat nga:	Viti 2017-2018
Pushteti qendror/ vendor	-
Fonde jopublike:	-
Grantet për kërkim dhe kontratat	-
Konsulencat, shërbimet	-
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	35'880'000
Sponsorizimet	-
Shërbimet trainuese (kualifikimi i	-

vazhdueshëm)	
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj.	-
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj.)	170'000
<b>SHUMA</b>	<b>36'050'000</b>

Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Tabela 9)

Tabela 9

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Desara Agaj	Përgjegjëse	2 vite
2	MSc. Sidita Çoniku	Specialiste	2.5 vite
3	MSc. Manjola Llubani	Asistente	4 muaj
4	Dr. Manjola Kapedani	Anëtar i grupit të SC në nivel njësie bazë	2 vite
5	Dr. Fatmira Kola	Anëtar i grupit të SC në nivel njësie bazë	1 vit
6	MSc. Aida Veliaj	Anëtar i grupit të SC në nivel njësie bazë	2 vite

Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10

Tabela 10



Viti I		Semestri	ECTS	Orë në javë	Bachelor në Menaxhim Biznesi										Provime
Viti II					Orë mësimore										
Viti III					Leksione			Seminare			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej		
Lëndë/Module					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur					
<b>Viti I</b>															
1	Hyrje në ekonomi	I	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
2.1	Matematikë e përgjithshme	I	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
3.1	Gjuhë e huaj 1	I	5	4	4	45	55	1	15	10	60	65	125	1	
4.1	E Drejtë Publike	I	4	3	3	30	45	1	15	10	45	55	100	1	
5	Histori e Mendimit Ekonomik	I	4	3	3	30	45	1	15	10	45	55	100	1	
2.2	Matematike financiare (e zbatuar)	II	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
3.2	Gjuhë e huaj 2	II	5	4	4	45	55	1	15	10	60	65	125	1	
6	Organizim drejtim biznesi	II	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
4.2	E Drejtë Biznesi	II	4	3	3	30	45	1	15	10	45	55	100	1	
7	Bazat e Financës	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
<b>Totali, viti I</b>			60	41	40	390	610	20	225	275	615	885	1500	10	
<b>Viti II</b>															
1	Statistikë	I	7	5	4	45	55	3	30	45	75	100	175	1	
2.1	Mikroekonomi	I	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
3.1	Parime Kontabiliteti	I	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
4	Baza Marketingu	I	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
5	Informatike	I	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
2.2	Makroekonomi	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
3.2	Kontabilitet Financiar	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
6	Manaxhim i Burimeve Njerëzore	II	5	4	4	45	55	1	15	10	60	65	125	1	
7	Financa Publike	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
8	Lëndë me zgjedhje (1 nga 2)	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
	Integrimi dhe politikat e BE	II													
	Sistemi i taksave dhe tatimeve	II													
<b>Totali, viti II</b>			60	41	32	330	470	28	285	415	615	885	1500	10	
<b>Viti III</b>															
1	Manaxhim Prodhimi dhe Operacionesh	I	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
2	Kontabilitet Kosto-Drejtimi	I	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
3.1	Strategji Biznesi	I	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
4.1	Analiza Financiare	I	7	5	4	45	55	3	30	45	75	100	175	1	
3.2	Biznes Ndërkombëtar	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
4.2	Drejtim Financiar	II	8	5	5	45	80	3	30	45	75	125	200	1	
5	Lëndë me zgjedhje (1 nga 2)	II	6	4	3	30	45	3	30	45	60	90	150	1	
	Manaxhim, Vlerësim Projektesh	II													
	Auditimi	II													
6	Praktika	II	5								45	80	125		
7	Teza e diplomës	II	6								75	75	150		
<b>Totali, Viti III</b>			60	32	28	270	430	21	210	315	600	900	1500	7	
<b>TOTALI</b>			180	114	100	990	1510	69	720	1005	1830	2670	4500	27	

Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (Tabela 11)

Tabela 11

<b>PLANI MËSIMOR për programin e studimit Bsc në Menaxhim Biznesi</b>		
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kredite/ ECTS
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	1. Matematikë MI: Matematikë e Përgjithshme MII: Matematikë Financiare ( e zbatuar ) 2. Hyrje në Ekonomi 3. Bazat e Financës 4. Histori e Mendimit Ekonomik	30
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	5. Mikro dhe Makroekonomi MI: Mikroekonomi MII: Makroekonomi 6. Kontabilitet MI: Parimet e Kontabilitetit MII: Kontabilitet Financiar 7. Drejtim Financiar dhe Analizë Financiare MI: Analizë Financiare MII: Drejtim Financiar 8. Strategji Biznesi dhe Biznes Ndërkombëtar MI: Strategji Biznesi MII: Biznes Ndërkombëtar 9. Organizim Drejtim Biznesi 10. Manaxhim Prodhimi dhe Operacionesh 11. Manaxhim i Burimeve Njerëzore 12. Bazat e Marketingut 13. Kontabilitet Kosto-Drejtimi 14. Financa Publike	93
Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	15. Parimet e të Drejtës MI: E Drejtë Publike MII: E Drejtë Biznesi 16. Statistikë	18
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	17. Sistemi i Taksave dhe Tatimeve <b>ose</b> Integrimi dhe Politika e BE-së 18. Manaxhim, Vlerësim Projektsh <b>ose</b> Auditim	12
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	19. Gjuhë e Huaj MI: Gjuhë e Huaj 1 MII: Gjuhë e Huaj 2 20. Informatikë 21. Praktika Profesionale	21
Teza e Diplomës (F)	22. Teza e Diplomës	6
<b>Totali</b>		<b>180</b>

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Tabela 12)

Tabela 12

Viti I (Viti II) (Viti III)	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Punë e Pavarur	Gjithsej	Provime
					Leksione			Seminare			Ushtrime			Detyrë					
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur			
1	Hyrje në Ekonomi	I	8	5	5	45	80	3	30	45						75	125	200	1
	Hyrje në Ekonomi	I	7	5.5	3	30	45	1	8	17						83	92	175	1
2	Matematikë e Përgjithshme	I	8	5	5	45	80	3	30	45						75	125	200	1
	Matematikë e Përgjithshme	I	7	6	3	30	45									90	85	175	1
3	Histori e Mendimit Ekonomik	I	4	3	3	30	45	1	15	10						45	55	100	1
	Histori e Mendimit Ekonomik	I	6	3.1	3	30	45	2	15	35						47	103	150	1
4	Statistikë	I	7	5	4	45	55	3	30	45						75	100	175	1
	Statistikë	I	6	5	3	30	45									75	75	150	1
5	Baza Marketingu	I	6	4	3	30	45	3	30	45						60	90	150	1
	Baza Marketingu	I	7	4.1	3	30	45	2	15	35						62	113	175	1
6	Biznes Ndërkombëtar	I	6	4	3	30	45	3	30	45						60	90	150	1
	Biznes Ndërkombëtar	I	7	4.5	3	30	45	3	23	52						68	107	175	1
7	Drejtim Financiar	I	8	5	5	45	80	3	30	45						75	125	200	1
	Drejtim Financiar	I	7	5.5	3	30	45	1	8	17						83	92	175	1
	Ndryshime në total*	0	8	2.8	7	60	115	12	126	188						43	219	200	0

• Ndryshimet konsistojnë vetëm në ndryshimin e numrit të krediteve të lëndëve që ka kurrikula dhe në organizimin e formave të mësimdhënies nga leksione/seminare në leksione/seminare/ushtrime/detyra.

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabela 13)

Tabela 13

Lënda /Moduli	Pedagogu /Pedagogët përgjegjës	Titulli/ grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1. Analiza Financiare	Ilda Kadrimi/ Klodia Kola	MSc./ MSc.	Shkencat Ekonomike	45/60	PAE/PAE
2. Bazat e Financës	Aida Veliaj/ Marsida Omari	MSc./ MSc.	Shkencat Ekonomike	30/30	PAE/PAK
3. Bazat e Marketingut	Manuela Meçe	Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	90	PAE
4. Biznes Ndërkombëtar	Klodiana Gorica	Prof. Dr.	Shkencat Ekonomike	90	PAK
5. Drejtim financiar	Ingrid Konomi	Dr.	Shkencat Ekonomike	90	PAE
6. E Drejtë Biznesi	Amanda Vrioni	MSc.	Shkencat Ekonomike	45	PAE
7. E Drejtë Publikë	Rezana Balla/ Ermira Shtino	Dr./ Ma.	Shkencat Ekonomike	30/15	PAE/PAK
8. Financa Publike	Aida Veliaj/ Pandi Madhi	MSc./ MSc.	Shkencat Ekonomike	60/30	PAE/PAK
9. Gjuhë e Huaj 1	Sonila Daiu	Dr.	Shkencat Ekonomike	60	PAE
10. Gjuhë e Huaj 2	Ledia Kazazi	Dr.	Shkencat Ekonomike	60	PAK
11. Histori e Mendimit Ekonomik	Sonila Shamku/ Stavri Sinjari	Ma./ Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	15/30	PAE/PAK
12. Hyrje në Ekonomi	Galantina Canco/ Ornela Kullolli	Prof.Dr./ Ma.	Shkencat Ekonomike	45/30	PAK/PAK
13. Informatikë	Besmir Kanushi	MSc.	i Inxhinierive	90	PAE
14. Integrimi dhe politikat e BE	Sonila Shamku/ Perseta Grabova	Ma./Dr.	Shkencat Ekonomike	60/30	PAE/PAK
15. Kontabilitet Financiar	Remzi Sulo/ Albana Jupe	Prof.Asoc./ Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	60/30	PAE/PAK
16. Makroekonomi	Armalda Reçi/ Galantina Canco	Dr.proc./ Prof.Dr.	Shkencat Ekonomike	60/30	PAE/PAK
17. Man. Prodhimi dhe Operacionesh	Genti Çela	Dr.	Shkencat Ekonomike	105	PAE
18. Menaxhim i Burimeve Njerëzore	Almarin Frakulli/ Marsela Tafa/ Dafina Cenaj	Dr. proc./ MSc./ Dr.	Shkencat Ekonomike	90/60/15	PAE/PAE/PAK
19. Manaxhim, Vlerësim Projektsh	Avis Andoni	Dr.	Shkencat Ekonomike	90	PAE
20. Matematikë e Përgjithshme	Agron Kodra	Docent	Shkencat Ekonomike	75	PAK
21. Matematike financiare (E zbatuar)	Setki Mulla	Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	75	PAE
22. Mikroekonomi	Eda Bezhani/ Elida Liko	Prof.Asoc./ Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	60/30	PAK/PAK
23. Organizim Drejtim Biznesi	Manuela Meçe	Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	75	PAE
24. Parimet e Kontabilitetit	Remzi Sulo/ Albana Jupe	Prof.Asoc./ Prof.Asoc.	Shkencat Ekonomike	30/60	PAE/PAK
25. Statistikë	Agron Tato	Prof.Dr.	Shkencat Ekonomike	105	PAE
26. Strategji Biznesi	Manjola Kapedani	Dr.	Shkencat Ekonomike	105	PAE

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (Tabela 14)

Tabela 14

Programi i Studimit BSc në Menaxhim Biznesi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	990
Seminare	720
Praktikë profesionale	45
Diploma/Provim Formimi	75
Në total	1830

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

Tabela 15

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%
Testimet gjatë vitit	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njesisë (Tabela 16)

Tabela 16

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	20
Për projekte shkencore në rang Departamenti	5
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	11
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	13

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 17)

Tabela 17

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Studente të transferuar për Brezat (b)	Totali: (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2017-2018	37	7.05	8	2	10	-	-	-	20	57

- Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela 18)

Tabela 18

Periudha e të dhënave 2017-2018			
Programi i studimit	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
BSc në Menaxhim Biznesi	68	35%	25%

- Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për progr. e studimit (Tabela 19)

Tabela 19

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	29
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	1
3.	Numri i projekteve të zbatuara	1
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit	15
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	11
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	15
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	3
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	-

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 20)

Tabela 20

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	25
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	0
3	Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	25
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	20
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	1
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	29
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	-

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 21)

Tabela 21

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese		
Organizata:		Lloji i bashkëpunimit
1	Studio IRS, Financë Auditim	Praktika Mësimore
2	Capital Invest sh.a	Praktika Mësimore
3	ANAS sh.p.k	Praktika Mësimore
4	Perlut sh.a	Praktika Mësimore
5	Alba Trans sh.p.k	Praktika Mësimore
6	Tirana Auditing 2 sh.p.k	Praktika Mësimore
7	Inter B.B.K Auditing sh.p.k	Praktika Mësimore
8	NH Euroconsult sh.p.k	Praktika Mësimore
9	AK Invest sh.a	Praktika Mësimore
10	BDO Albania sh.p.k	Praktika Mësimore
11	ProCredit Bank	Praktika Mësimore
12	A.S.C.A sh.p.k	Praktika Mësimore
13	Mediterranean Business Center	Praktika Mësimore
14	GB Group sh.p.k	Praktika Mësimore
15	GRANIT IMPORT-AL sh.p.k	Praktika Mësimore
16	AMCO sh.p.k	Praktika Mësimore
17	DESLA sh.p.k	Praktika Mësimore
18	Unioni Financiar Tiranë	Praktika Mësimore
19	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Projekte, Evente, Praktika
20	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike	Projekte, Evente, Praktika
21	IDRA	Praktika Mësimore, Projekte, Shkëmbim stafi
22	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë	Praktika Mësimore, Projekte, Shkëmbim stafi
23	Parilaku sh.p.k	Praktika Mësimore
24	Tirana Urban Trans sh.a	Praktika Mësimore
Universitete:		
1	Universiteti i Tiranës	Shkëmbim stafi
2	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Shkëmbim stafi
3	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Shkëmbim stafi, Projekte, Evente
4	Kolegji Universitar Qirjazi	Evente, Projekte
5	Universiteti Ningbo Dahongying, Kinë	Shkëmbim stafi, Projekte, Evente
6	Kolegji Powislanski, Poloni	Erasmus +
7	Universiteti "Angel Kanchev" Ruse	Shkëmbim stafi, Projekte, Evente